

Televizioni në Evropë:

Raporti për mbikëqyrjen  
e situatës 2008

*Published by*

OPEN SOCIETY INSTITUTE

Október 6. u. 12.  
H-1051 Budapest  
Hungary

400 West 59th Street  
New York, NY 10019  
USA

© OSI/EU Monitoring and Advocacy Program, 2008  
All rights reserved.



TM and Copyright © 2008 Open Society Institute

EU MONITORING AND ADVOCACY PROGRAM

Október 6. u. 12.  
H-1051 Budapest  
Hungary

*Websites*

<[www.eumap.org](http://www.eumap.org)>

<[www.mediapolicy.org](http://www.mediapolicy.org)>

*Design & Layout by Q.E.D. Publishing*

## Falënderim

Ky raport është i përgatitur si pjesë e një seriali të raporteve për monitorim të kryer me titull: “Televizioni në Evropë: raport për zhvillimin e situatës për vitin 2008”.

Seriali mundëson një pasqyrë të situatës në 9 nga 20 shtetet fillestare të përfshira me serialin e raporteve që nga viti 2005, të titulluara “Televizioni në Evropë: rregullat, politikat dhe pavarësia. Në raportet për vitin 2008 janë të përfshira: Shqipëria, Bullgaria, Çekia, Italia, Lituania, Maqedonia, Polonia, Rumania dhe Sllovakia.

Dy serialet e raporteve janë të përgatitura nga EU Monitoring and Advocacy Program (EUMAP) të Open Society Institute dhe nga Media Program të Open Society Institute, në bashkëpunim me ekspertë lokal. EUMAP dhe Media Program theksojnë rolet udhëheqëse në hulumtimet dhe përgatitjen e propozimit të këtij raporti të personave në vijim.

Përgjegjësia për përmbajtjen e raporteve është e dy programeve.

**“Televizioni në Evropë – raportet plotësuese 2008, Maqedoni”.**

### Redaktorë

Marius Dragomir (Media Program) *redaktor dhe menaxher i projektit*

Mark Thompson (Media Program) *redaktor*

### Raportues nga Maqedonia

Vesna Shopar *Universiteti Evropian – R. e Maqedonisë*

### Stafi i Institutit Shoqëria e Hapur

Gordana Janković (Media Program) *drejtore i programit*

Biljana Tatomir (Media Program) *zëvendës-drejtore*

Miriam Anati (EUMAP) *përfaqësim dhe komunikacione*

Andrea Gurubi Watterson (EUMAP) *koordinator i programit*

Csilla Tóth (EUMAP) *asistent i programit*

Joost Van Beek (EUMAP) *menaxher i faqes së internetit*

Sergey Shabanov (EUMAP) *zhvillim i faqes së internetit*

Falënderojmë Qendrën për Gazetari të Pavarur (CJI) dhe Agjencinë për Monitorimin e mediave, për përkrahjen lidhur me distribuimin e raportit dhe posaçërisht falënderojmë Joana Avadanin, drejtore ekzekutive e Qendrës, e cila mundësoi përkthimin e këtij dokumenti.

# Hyrje

*Televizioni në Evropë: Raportet për zhvillimin e situatës në vitin 2008* është projekt për monitorim i EU Monitoring and Advocacy Program (EUMAP) të Open Society Institute dhe Media Program të Open Society Institute. Projekti ndërlidhet me rezultatet e raporteve paraprake të Televizionit në Evropë: rregullat, politikat dhe pavarësia, të publikuara në tetor të vitit 2005, me të cilin ishin të përfshira 20 shtete.

Përfundimi nga raportet e vitit 2005 ishte se roli qendror i televizionit si përkrahës i demokracisë në Evropë është nën një kërcënim serioz. Raportet treguan se serviset radiodifuzive publike ishin të detyruara të bëjnë kompromise lidhur me cilësinë, që të mund të garojnë me kanalet komerciale, si dhe se një numër i madh i serviseve publike ishin të varur nga qeveritë ose nga partitë politike. Po ashtu, evidente ishte edhe rritja e koncentrimit në sektorin komercial, në shumë raste me lidhje evidente politike. Zhvillimi i këtillë i ngjarjeve paraqiste kërcënim për pluralizmin në radiodifuzion, me ç'rast rreziku më i madh ishte i regjistruar në demokracitë e reja të Evropës Qendrore dhe asaj Lindore.

Projekti paraprak Televizioni në Evropë si dhe aktivitetet për përfaqësim, përfunduan në Qershor të vitit 2006. Që atëherë, Media Program financoi disa projekte për mbikëqyrjen e gjendjes, të implementuara nga organizata partnere në shtetet e zgjedhura, me qëllim që të bëhet promovimi i raporteve dhe të plotësohen rezultatet si dhe përfundimet.

Në shumë nga shtetet e përfshira në raportet nga viti 2005, janë regjistruar ndryshime të rëndësishme në një numër të madh të sferave të monitoruara. Që nga fillimi i projektit, në mars të vitit 2008 në Londër, *Televizioni në Evropë: raport për zhvillimet e situatës 2008*, ka bërë mbikëqyrjen e këtyre ndryshimeve në 9 nga 20 shtetet të cilat ishin të përfshira në programin fillestar të monitorimit: Shqipëria, Bullgaria, Çekia, Italia, Maqedonia, Polonia, Rumania dhe Sllovakia. Këto shtete ishin të zgjedhura për shkak të ndryshimeve permanente të rëndësishme në sferën e radiodifuzionit.

*Televizioni në Evropë: raport për zhvillimet e situatës 2008* përshkruan ndryshimet kryesore në legjislacionin radiodifuziv, politikat dhe tregjet në tre vitet e fundit dhe bën vlerësimin e zhvillimit, apo mungesës së zhvillimit, që këta shtete e kanë arritur në avancimin e pavarësisë dhe pluralizmit në sektorët e tyre të radiodifuzionit.

Si edhe në raportet paraprake të vitit 2005, ky version i azhuruar u është dedikuar bartësve të politikave, aktivistëve të shoqërisë qytetare dhe komunitetit akademik, si kontribut për realizmin e ndryshimeve, aty ku ato janë të nevojshme.

Raportet në këto shtete i përgatitën ekspertë lokal, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare partnere. Të gjitha raportet janë të përgatitura sipas të njëjtës metodologji, që mundëson një analizë komparative. Në fund, përgjegjësia për përmbajtjen është e ISHH dhe FISHH.

## Për EUMAP

EUMAP, EU Monitoring and Advocacy Program të Open Society Institute, përcjell zhvillimin e të drejtave të njeriut të selektuara dhe sundimin e së drejtës në vendet e Unionit Evropian dhe ne shtetet kandidatë dhe kandidatët potencial për anëtarësim.

EUMAP bashkëpunon me ekspertë vendor dhe organizata joqeveritare (OJQ) në grumbullimin e të dhënave për raportet, të cilat distribuohen në tërë Evropën dhe në botë. Raportet kanë për qëllim të inkurajojnë një pjesëmarrje më të madhe në procesin e artikullimit të vlerave të përbashkëta demokratike të UE-së, si dhe në monitorimin për respektimin e standardeve të së drejtave të njeriut në Union.

Përveç raporteve nga projekti Televizioni në Evropë, EUMAP, për momentin është i fokusuar edhe në qasjen e romëve drejt arsimimit si dhe në situatën në të cilën gjenden myslimanët në disa shtete anëtare të UE-së.

Raportet paraprake të EUMAP, përfshijnë edhe raportet Televizioni në Evropë në vitin 2005, si dhe raportet për mbrojtjen e pakicave, të drejtat e personave me hendikep intelektual, pavarësinë e gjyqit, kapacitetet e sistemit të jurisprudence, korrupsionit dhe politikave anti-korruptive, si dhe mundësi të njëjta mes gjinive.

Të gjitha raportet e EUMAP, si dhe informata plotësuese, janë në dispozicion në ueb-faqen [www.eumap.org](http://www.eumap.org).

## Për Media Program

Media Program ka për qëllim promovimin e mediave të pavarura, profesionale dhe të qëndrueshme si dhe të gazetarisë cilësore, para së gjithash në shtetet të cilat janë duke kaluar nëpër procesin e demokratizimit dhe të ndërtimit të tregjeve funksionale të mediave.

Media Program përkrah iniciativat të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë në harmonizimin e legjislacionit të mediave me standardet ndërkombëtare, avancimin e profesionalizmit të gazetarëve dhe menaxherëve të medieve, avancimin e shoqatave të profesionistëve të mediave dhe vendosjen e mekanizmave të vetërregullimit. Media Program po ashtu u jep përkrahje media të cilat përfaqësojnë vlerat e shoqërisë së hapur, si dhe japin kontributin në kundërvënien ndaj shkeljes së lirisë së medieve dhe promovojnë ndryshime në politikat e mediave të cilat sigurojnë pluralizëm të pronësisë së mediave dhe llojllojshmëri në mendime.

Edhe pse Media Program, është tradicionalisht i fokusuar në Evropën Qendrore, Lindore dhe Jug-Lindore, ZND dhe Mongol, gjatë disa viteve të kaluara, programi ka zgjeruar vëmendjen e vet edhe në Afrikën jugore dhe perëndimore, Azinë Jug-Lindore dhe Amerikën Latine.

Televizioni në Evropë:  
Raporti për mbikëqyrjen e situatës 2008

Maqedonia

nga Vesna Shopar

## Tabela e lëndës

A. Rezyme .....	11
B. Rekomandime .....	13
1. Rekomandime origjinale nga raporti për 2005 .....	13
1.1 Politikat .....	13
1.2 Organet rregullatorë .....	15
1.3 Marrëdhëniet në industri dhe çështjet etike .....	16
2. Rekomandimet e reja të bazuara në raportin për 2008 .....	16
2.1 Politika e mediave dhe legjislacioni .....	16
2.2 Këshilli për Radiodifuzion .....	16
2.3 Servisi Radiodifuziv Publik .....	17
2.4 Radiodifuzioni komercial .....	17
C. Konstatimet kryesore të monitorimit për zhvillimin e situatës .....	18
1. Ambienti i përgjithshëm në të cilin funksionon radiodifuzioni .....	18
1.1 Risitë kryesore në legjislacion dhe në politikat .....	18
1.2 Dispozitat ligjore në UE .....	21
1.3 Tregu radiodifuziv .....	23
2. Rregullativa dhe licencimi në sektorin televiziv .....	24
2.1 Organet rregullatore dhe kornizat .....	24
2.2 Sistemi i licencave .....	30
3. Rregullativa dhe menaxhimi me Servisin Televiziv Publik (SRP) .....	33
3.1 Legjislacioni dhe politikat e SRP-së .....	33
3.2 Struktura drejtuese e SRP-së .....	36
3.3 Financimi i SRP-së .....	39
3.4 Standartet redaktorialë .....	42
4. Radiodifuzioni komercial .....	43
4.1 Rregullativa dhe menaxhimi .....	43
4.2 Pronësia dhe pronësia e kryqëzuar .....	43
4.3 Tregu reklamues .....	46

4.4 Standertet editoriale dhe pavarësia .....	47
4.5 Radiodifuzioni rajonal dhe lokal .....	48
5. Programet .....	49
5.1 Oferta programore .....	49
5.2 Dispozitat e përgjithshme dhe kuotat .....	50
5.3 Obligimet e SRP-së .....	51
6. Përfundime .....	52
ANEKS 1. Legjislacioni i cituar në këtë Raport .....	53
ANEKS 2. Bibliografi .....	54

## Indeksi i tabelave

Tabela 1. Pasqyrë e zhvillimeve në legjislacionit në Maqedoni 2005–2007 .....	22
Tabela 2. Shikueshmëria e TV kanaleve udhëheqëse në vitin 2007 .....	24
Tabela 3. Kompetencat e reja të Këshillit për radiodifuzion për shqiptimin e masave ndëshkuese .....	28
Tabela 4. Buxheti I RTM-së për 2005–2006 .....	41
Tabela 5. Pjesëmarrja në të ardhurat nga reklamimi të televizioneve në bruto për vitin 2006 .....	47
Tabela 6. Emisionet të stacioneve më të mëdha televizive në vitin 2006 (në për qindje) .....	49

## Lista e shkurtesave

AKE	Agjencia për Komunikacione Elektronike
AMEPM	Asociacioni i Mediave Private Elektronike në Maqedoni
QZHM	Qendra për Zhvillimin e Mediave
MRD	Radiodifuzioni i Maqedonisë
MR	Radioja e Maqedonisë
RTM	Radio-Televizioni i Maqedonisë
TVM	Televizioni i Maqedonisë



OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim ne Evropë
NPSHAN	dërmarrja Publike për Shërbime të Aeroportit
SMMI	Marketing Strategjik dhe Hulumtime të Mediave
VMRO-DPMNE	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtarë Maqedonas
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

## A. Rezyme

Në tre vitet e përgatitjes së raportit paraprak Televizioni në Evropë për Maqedoninë, pamë disa risi paradoksale në radiodifuzionin e Maqedonisë. Nga njëra anë, Kuvendi më në fund aprovoi një legjislacion progresiv i cili solli Maqedoninë në nivel me standardet evropiane për pavarësi rregullative dhe radiodifuzion publik. Nga ana tjetër, një zhvillim i tillë kishte një efekt minimal mbi problemet e shumta strukturale në sektorin e radiodifuzionit.

Sipas Ligjit për radiodifuzion, televizioni në Maqedoni përbëhet nga stacione televizive publike, komerciale dhe joprofitabile, si dhe nga rrjetet kablore dhe satelitore. Ndërmarrja radiodifuzive publike është e ballafaquar me probleme të shumta, të cilat janë aq të thella, sa që është vështirë të parashikohet se kur mund të zgjidhen. Krahas procesit tepër të gjatë të rikonstruimit, servisi radiodifuziv publik është i paralizuar nga kriza financiare, kadrovike dhe programore. Televizioni komercial dominon në listat e rejtungejeve, me skema programore të cilat as nuk janë të përafërta me standardet e servisit publik, e as që stimulojnë produksionin cilësor lokal.

Licencat për emetim kabllor dhe satelitor nuk janë të dhënë. Operatorët aktual kabllor në Maqedoni bëjnë pako të kanaleve të huaja më një ofertë të gjerë të programeve dhe shërbimeve. Radiodifuzerët joprofitabil janë akoma në fillim, me një përfshirje të dobët. Tregu në Maqedoni është i stërngarkuar, me 114 radio stacione dhe stacione televizive, ndërsa cilësia e programit është nën nivel. Programet janë monotone dhe në to nuk investohet shumë. Në skemat programore dominonë zbatimja dhe pak programe cilësore të prodhuara në nivel lokal.

Korniza ligjore kishte ndryshime të rëndësishme në vitin 2005, para së gjithash falë miratimit të ligjit të ri për radiodifuzion atë vit, i cili më vonë u ndryshua me amendamente. Legjislacioni respekton standardet audiovizuale dhe legjislacionin e mediave evropian (*acquis communautaire*), sidomos **dispozitat** lidhur me produksionin evropian, reklamimin, sponsorizimin dhe tele-shoppingun. Procedura e marrjes së lejes radiodifuzive është liberalizuar, si për radiodifuzerët vendor ashtu edhe për ato të huaja. Koncentrimi i mediave është i përcaktuar në mënyrë precize, por këto rregulla akoma nuk implementohen. Pavarësia e servisit radiodifuziv publik dhe të trupit rregullativ është e avancuar me legjislacionin e ri.

Krahas turbulencave në disa pjesë, implementimi i legjislacionit të ri realizohej sipas planit. U emëruan anëtarë të rinj të Këshillit për Radiodifuzion krahas presionit të madh i cili vinte nga ana e shoqërisë civile dhe Komisionit Evropian, të cilët insistonin që partitë politike të jenë jashtë procesit. Këshilli fitoi disa kompetenca plotësuese dhe u tentua të bëhet implementimi më efikas i ligjit, duke iu falënderuar edhe për krahas të cilën e kishin nga ekspertët lokal dhe ndërkombëtar. Këshilli për radiodifuzion miratoi Strategjinë për zhvillimin e radiodifuzionit, së bashku me Planin e përshtatshëm aksional.

Edhe pse Qeveria refuzoi ta përkrah strategjinë, Këshilli për Radiodifuzion filloi me implementimin e Planit Aksional.

Ajo që mungon është implementimi efikas i disa nga masave konkrete kundër radiodifuzerëve të cilët bëjnë shkelje të ligjit, posaçërisht në sferën e pronësisë, standardeve programore dhe reklamimit.

Në drejtorinë e Radio-Televizionit e Maqedonisë (RTM) kishte disa ndryshime. Në vitin 2006 dhe 2007, lidershipi dhe redaktorët u ndërruan disa herë, gjë që kishte efekt negativ mbi programin dhe rejtingun. Problemet financiare janë duke u thelluar. Financimi nga mjetet e grumbulluara nëpërmjet taksës radiodifuzive, nga të cilat pjesërisht varet RTM-ja, rra në nivel shumë të ulët; pagesa rra në mënyrë drastike në vitin 2007 në jo më shumë se 0.5 për qind të amvisërive. Financimi nga fondet e Qeverisë dhe Buxhetit të RM-së janë vetëm një masë e përkohshme e cila ka ndikim negativ mbi pavarësinë e ndërmarrjes. Kjo, po ashtu është diskutabile për shkak të faktit se shteti ka të drejtë të financojë vetëm disa emisione specifike në servis publik, siç janë programi dedikuar mërgimtarëve.

Sot, problemi kryesor është jogatishmëria e lidershipit të RTM-së të tentojë ta grumbullojë taksën radiodifuzive në mënyrë më efektive, për shkak se është më lehtë të priten donacionet nga Qeveria. Ky qëndrim pasiv ndaj situatës katastrofike është në mënyrë sistematike e iniciuar nga ana e politikanëve të cilët dëshirojnë që RTM-ja financiarisht të varet nga shteti.

Radiot dhe televizionet komerciale, kompletuan procesin e ndërrimit të kontratave të vjetra të koncesionit me licencat radiodifuzive, të cilat i jep Këshilli për Radiodifuzion. Paralelisht me aktivitetet për avancimin e pavarësisë së Këshillit, kjo masë duhet ta zvogëlojë ndikimin e Qeverisë në rregullimin e sektorit radiodifuziv. Nga ana tjetër, oferta programore nuk është përmirësuar dhe nuk ka ndryshime në strukturën e pronësisë, krahas shkeljeve të kohëpaskohshme të rregullave të koncentrimit të mediave.

Tregu i radiodifuzionit kabllor kalon nëpër ndryshime dramatike dhe turbulente. Tani më ka 118 operatorë lokal, nga të cilët vetëm 53 i kanë regjistruar pakot e tyre programore te Këshilli për Radiodifuzion. Të tjerët vazhdojnë të punojnë pa rregulluar të drejtat autoriale për programet që emetojnë. Ndërkohë, sektori kabllor u konsolidua. Një investitor i huaj bleu 13 operatorë kabllor në pjesën qendrore të Maqedonisë dhe ka plane për investime të reja. Tetë operatorë kabllor nga pjesa qendrore dhe jugore e Maqedonisë formuan konsorcium si tentim për mbrojtje nga mundësia e blerjes nga ana e investitorëve të huaj.

## B. Rekomandime

### 1. REKOMANDIME ORIGJINALE NGA RAPORTI PËR 2005<sup>1</sup>

#### 1.1 Politikat

<i>Legjislacioni i mediave</i>	
<p>1. Kuvendi dhe Qeveria duhet të miratojnë ligjin e ri për radiodifuzion sa më parë. Ky obligim është i parashikuar edhe në “përgjigjet në pyetjet plotësuese nga Pyetëtori I UE-së për kriteret ekonomike dhe pjesët e Acquis<sup>2</sup>”.</p> <p>2. Shoqëria civile, industria e mediave dhe komuniteti akademik duhet të insistojnë në realizimin e këtij obligimi dhe në mënyrë intensive të përcjellë dhe të ndihmojë procedurën kuvendore.</p> <p>3. Kuvendi dhe Qeveria duhet të sigurojnë implementim të plotë të Ligjit të ri për radiodifuzion pas miratimit të tij, sidomos nga aspekti i vendosjes së institucioneve të RTM-së të parashikuara me ligj, si dhe të sigurojnë garanci ligjore dhe politike për pavarësinë e saj.</p>	<p>Rekomandimet 1 dhe 2 janë të implementuara. Ligji për radiodifuzion nga viti 2005 kishte ndikim pozitiv. Rekomandimi i tretë nuk u aprovua, por ende mbetet relevant. Nga ana tjetër, në vend të Kuvendit dhe Qeverisë, Këshilli për Radiodifuzion duhet të marrë një qëndrim më aktiv ndaj implementimin të plotë të dispozitave të Ligjit për Radiodifuzion.</p>

<sup>1</sup> “Republic of Macedonia” in Open Society Institute, *Television across Europe: regulation, policy and independence*, Budapest, 2005 (hereafter OSI/Republic of Macedonia), pp. 1,224–1,226.

<sup>2</sup> Qeveria e RM “Përgjigje në pyetjet plotësuese nga Pyetëtori I UE-së për çështje ekonomike dhe pjesës së Acquis”, internet <http://www.sei.gov.mk/prasalnik>.

<i>Politika radiodifuzive</i>	
<p>4. Kuvendi, si themelues i Radio-Televizionit të Maqedonisë (RTM), duhet të organizojë debate për ardhmërinë e servisit radiodifuziv publik. Qëllimi kryesor i debatit duhet të jetë miratimi i strategjisë për konsolidim financiar, modernizimin e mjeteve dhe avancimin e resurseve njerëzore.</p>	<p>Ky rekomandim nuk është implementuar. Sipas Ligjit për radiodifuzion të vitit 2005, Kuvendi më nuk është themelues i RTM-së. Por, mbetet nevoja e debatit për ardhmërinë e RTM-së. Këshilli për Radiodifuzion duhet të organizojë një debat të gjerë për ardhmërinë e servisit publik radiodifuziv, me inkuadrimin e ministrive kompetente, RTM-së dhe ekspertëve të mediave. Pas debatit, Këshilli për Radiodifuzion duhet të bëjë presion mbi Këshillin dhe Bordin Drejtues të RTM-së, për implementimin e rekomandimeve të cilat do të jenë rezultat i debatit.</p>
<p>5. Këshilli për Radiodifuzion bashkë me Komitetin për Zhvillimin e Rrjetit Radiodifuziv, duhet të organizojë sa më shpejt debat të gjerë publik për Strategjinë kombëtare për sektorin radiodifuziv.</p> <p>6. Qeveria duhet ta sigurojë përgatitjen e propozimit të Strategjisë nacionale për sektorin radiodifuziv, me inkuadrimin e eksperiencave vendore dhe standardeve dhe trendëve evropiane.</p> <p>7. Kuvendi, si prioritet duhet të miratojë Strategjinë si dhe të sigurojë implementimin e saj të plotë.</p>	<p>Rekomandimet 5, 6 dhe 7 janë pjesërisht të zbatuara. Këshilli për Radiodifuzion e miratoi Strategjinë për zhvillimin e radiodifuzionit, e cila më vonë ishte e pranuar nga ana e Komisionit kuvendor për transport dhe lidhje. Por, Qeveria e refuzoi këtë strategji në janar të vitit 2008. Qeveria duhet ta miratojë këtë strategji si pjesë e politikës shtetërore.</p>
<p>8. Qeveria duhet ta miratojë planin për hyrjen në fuqi të legjisllacionit të ri në lëmin e shoqërisë informatike dhe t'i miratojë rregullat për internet dhe teknologjitë e tjera.</p> <p>9. Qeveria duhet ta miratojë Strategjinë nacionale për komunikacione elektronike dhe teknologji informatike. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet përkrahjes së paraqitjes së teknologjive të reja informatike dhe shërbimeve. Bashkë me ekspertët nga universiteti dhe institucionet hulumtuese, pushteti publik, në realizimin e kësaj detyre, duhet t'i inkuadrojë edhe ndërmarrjet private.</p>	<p>Këto rekomandime ishin pjesërisht të implementuara. Qeveria e përgatiti propozimin e Strategjisë nacionale për komunikacione elektronike dhe shoqëri informatike, e cila ende nuk është e aprovuar nga ana e Kuvendit. Nga ana tjetër, masat e përcaktuara në Strategji, ndërmerren nga ana e institucioneve qeveritare si pjesë e planeve të tyre aksionale.</p>

<i>Përkrahja ndërkombëtare</i>	
<p>10. Organizatat ndërkombëtare të cilat e përkrahin zhvillimin e mediave, siç është departamenti për zhvillimin e mediave pran OSBE-së, duhet të vazhdojnë me përkrahjen e tyre financiare, teknike dhe profesionale, sidomos për media të cilat i plotësojnë interesat e grupeve të marginalizuara në shoqëri.</p> <p>11. Pakti për Stabilitet për Evropën Jug-Lindore, me anën e departamentit të tij për media, bashkë me grupin punues për media në RM, duhet të iniciojnë monitorimin e implementimit të Ligjit të ri për radiodifuzion, pas miratimit të tij.</p>	<p>Për shkak të faktorëve të jashtëm të cilët ndikuan në organizatat ndërkombëtare, rekomandimi 10 nuk ishte e mundur të implementohet. Organizatat ndërkombëtare duhet ta ripërtërijnë përkrahjen e tyre financiare, teknike dhe profesionale. Qendra për Zhvillimin e Mediave (QZhM) organizatë joqeveritare e cila kishte rolin udhëheqës në grupin punues për media, deri në përfundimin e punës së departamentit për media pranë Paktit për Stabilitet në vitin 2006, implementoi rekomandimin 11. QZhM vazhdoi ta përcjellë implementimin e Ligjit për Radiodifuzion.</p>

## 1.2 Organet rregullatorë

<i>Servisi radiodifuziv publik</i>	
<p>12. Këshilli për radiodifuzion, bashkë me radio-televizionin e Maqedonisë dhe organizatat e shoqërisë civile, duke inkorporuar edhe shoqatat gazetareske, sindikatat dhe komunitetin akademik, duhet të organizojë debata të gjerë publik për ardhmërinë e radiodifuzionit publik në Maqedoni, si përkrahje për procesin e transformimit të mëtutjeshëm të kësaj sfere.</p>	<p>Ky rekomandim nuk është implementuar. Ai mbetet relevant. Mbetem rekomandimi për debate kushtuar ardhmërisë së RTM-së. (shiko rekomandimin 4 në 1.1 politikat)</p>
<i>Përfaqësimi i pakicave</i>	
<p>13. Këshilli për Radiodifuzion, radiodifuzerët - RTM dhe radiodifuzerët komercial – si dhe ekspertët të mediave dhe palët e tjera të interesuara, duhet të hapin debata për etnicitetet në sferën publike, për të përcaktuar mënyrën me të cilën mediat do të kontribuojnë në krijimin e mirëkuptimit mes komuniteteve të cilat jetojnë në vend. Debati duhet të fokusohet në mënyrën me të cilën mediat mund t'i përmirësojnë performansat e tyre profesionale në krijimin e mirëkuptimit mes komuniteteve.</p>	<p>Ky rekomandim nuk është implementuar. Ende ekziston nevoja për një debat të tillë, i përcjellë me një sërë masash plotësuese.</p> <p>Për të inkurajuar mediat që ta japin kontributin e tyre në drejtim të promovimit të mirëkuptimit mes komuniteteve, Këshilli për Radiodifuzion duhet ta përkrah avancimin e sektorit joprotitabil të mediave, duke përkrahur mediat të cilat janë të fokusuar në komunikacionin ndëretnik. RTM-ja, e cila emeton programe në më shumë gjuhë të pakicave, por nuk pati sukses në promovimin e kohezionit shoqëror, duhet qartë të definojë qëllimet e saj në fushën e promovimit të multikulturës në programet e saj.</p>

### 1.3 Marrëdhëniet në industri dhe çështjet etike

<p>Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe shoqatat e tjera profesionale gazetareske duhet të vendosin sistem të debateve të rregullta lidhur me standardet profesionale gazetareske.</p> <p>Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë dhe shoqatat e tjera profesionale gazetareske duhet të fillojnë negociatat me pronarët e mediave lidhur me standardet e mediave, kodekset etike dhe lidhur me instrumentet e tjera vetë rregullatorë të dedikuara për mbrojtjen e integritetit të gazetarëve.</p> <p>Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë dhe shoqatat e tjera profesionale gazetareske duhet në mënyrë urgjente të vendosin marrëdhënie me sindikatën dhe të formulojnë platformë për mbrojtjen e të drejtave të punësuarve në industrinë e mediave.</p>	<p>Këto rekomandime ishin pjesërisht të implementuara. SHGM ishte më aktive në vitin 2007 dhe filloi të realizojë më tepër aktivitete nga të cilat gazetarët kishin dobi. Shoqata duhet të vazhdojë me iniciativat në lëmit e përmendura në këto rekomandime.</p>
---	---

## 2. REKOMANDIMET E REJA TË BAZUARA NË RAPORTIN PËR 2008

### 2.1 Politika e mediave dhe legjislacioni

1. Drejtoria e UE-së duhet të bëjë vlerësimin e implementimit të Ligjit për Radiodifuzion dhe Ligjit për komunikacione elektronike të vitit 2005. Sektori civil, mediat dhe komuniteti akademik në sferën e komunikimeve duhet të insistojnë në efikasitetin e implementimit të këtyre obligimeve.

### 2.2 Këshilli për Radiodifuzion

2. Këshilli për Radiodifuzion, në bashkëpunim me trupat e pavarura për monitorim, duhet të zhvillojnë një pako të standardeve për sektorin e radiodifuzionit, me tregues të vlerësueshëm. Kjo do ta ndihmojë Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve që të bëjë identifikimin e problemeve dhe mangësive në procesin e implementimit të legjislacionit në sferën e mediave dhe, kështu, në mënyrë graduale ta përmirësojë kornizën ligjore në sferën e radiodifuzionit. Me sistemin e kriterëve duhet të shërbehen edhe organet rregullatorë – Këshilli për Radiodifuzion dhe Agjencia për Komunikacione Elektronike në procesin e licencimit.

3. Këshilli për Radiodifuzion duhet të organizojë një numër të debateve me palët e interesuara, për të siguruar transparencën në miratimin e politikave.

4. Para hapjes së konkursit për licencim për emetim digjital, Këshilli për Radiodifuzion duhet të bashkëpunojë me Agjencinë për komunikacione elektronike në organizimin e një debati të gjerë, me pjesëmarrje të gjithë palëve të interesuara, lidhur me modelin rregullator më adekuat për ambientin e ri digjital, posaçërisht në lëmin e rregullimit të radiodifuzionit digjital tokësor.

### **2.3 Servisi Radiodifuziv Publik**

5. RTM-ja duhet të zhvillojë instrumente për grumbullimin më efikas të taksës radiodifuzive. Qeveria duhet të përkrah RTM-në në këtë proces, nëpërmjet institucioneve financiare siç janë autoritetet tatimore.

6. Këshilli i RTM-së duhet të angazhojë revizion të pavarur financiar, për punën e RTM-së dhe rezultatet e saj ti bëjë publike.

### **2.4 Radiodifuzioni komercial**

7. Asociacioni i mediave elektronike private në Maqedoni (AMEPM) duhet të miratojë një strategji të qartë për zhvillimin e sektorit radiodifuziv komercial.

8. Kuvendi duhet të plotësojë Ligjin për Radiodifuzion me dispozita të cilat do të obligojnë trupin rregullator antimonopol, komisionin për mbrojtjen e konkurrencës, të implementojë dispozitat e lidhura me koncentrimin e pronësisë tek mediat. Organi rregullator antimonopol duhet të shqyrtojë rastet e koncentrimin të pronësisë në sektorin e radiodifuzionit dhe të përmirësojë parregullsitë e gjetura.

9. Kuvendi duhet të plotësojë Ligjin për Radiodifuzion me dispozitat të cilat do të pamundësojnë pronësinë mbi mediat elektronike nga ana e politikanëve.

10. Këshilli për Radiodifuzion duhet të vendosë një trup të pavarur, në kuadër të strukturës së tij, për implementimin e matjeve të reja (people-meter) lidhur me shikueshmërinë dhe dëgjueshmërinë, duke siguruar me këtë një pasqyrë më të qartë të tregut radiodifuziv. Trupi duhet të financohet nga pjesa e mjeteve të grumbulluara nga pagesa e taksës radiodifuzive.



## C. Konstatimet kryesore të monitorimit për zhvillimin e situatës

### 1. AMBIENTI I PËRGGJITHSHËM NË TË CILIN FUNKSIONON RADIODIFUZIONI

#### 1.1 Risitë kryesore në legjislacion dhe në politikat

Gjatë disa viteve të fundit, radiodifuzioni në Maqedoni kaloi nëpër disa ndryshime të rëndësishme në disa sfera esenciale. Ligji i ri për komunikacione elektronike u miratua në shkurt të vitit 2005.<sup>3</sup> Në nëntor të njëjtit vit, Kuvendi miratoi ligjin e ri për radiodifuzion.<sup>4</sup> Komuniteti akademik në sferën e komunikimeve, ekspertët e mediave si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile ishin të inkuadruar në përpilimin e tekstit të ligjit, i cili sipas pohimeve të ekspertëve nga sfera e mediave, si nga vendi ashtu dhe nga jashtë, sollti ndryshime pozitive në rregullimin e pronësisë së mediave elektronike, politikës redaktuese në radiodifuzionin publik si dhe në pozitën e organeve rregullatore.

Në vitin 2006 u emëruan anëtarët e rinj të Këshillit për Radiodifuzion, Agjencisë për Komunikacione Elektronike si dhe trupat drejtuese të shtëpisë radiodifuzive publike.<sup>5</sup> Në shkurt të vitit 2007, Kuvendi bëri ndryshimin e Ligjit për Radiodifuzion.<sup>6</sup> Ndryshimi kryesor kishte të bëjë me menaxhimin e RTM-së, në kuptim të emërimit të trupit ekzekutiv dyanëtarësh në vend të funksionit paraprak të cilin e kryente një person.

Ndryshimi kryesor në sferën e politikave ishte miratimi i Strategjisë së re për zhvillimin e radiodifuzionit pas një procesi të gjatë dhe të rëndë. Këshilli për Radiodifuzion punoi në këtë strategji që nga qershori i vitit 2006, në konsultime me disa ekupe ekspertësh, duke përfshirë edhe atë të TAIEX, programi i Komisionit Evropian për ndihmë me ekspertë në implementimin e legjislacionit të UE-së.

Strategjia përfshin tregun radiodifuziv, pluralizmin dhe jonjëllojshmërinë e programeve televizive, zhvillimin e teknologjive të reja dhe digjitalizimin, si dhe piraterinë e përmbajtjeve – një nga problemet kyçe të cilat pengojnë tregun audio vizual në Maqedoni. Propozim verzioni i Strategjisë, i hapur për debat publik, u publikua në faqen e internetit të Këshillit në shtator të vitit 2007. Këshilli organizoi disa debate lidhur me strategjinë me mediat, ekspertë nga lëmi i drejtësisë dhe ekonomisë, si dhe me përfaqësuesit e shoqërisë civile, RTM-së dhe AKE-së.

<sup>3</sup> Ligji për Komunikacione Elektronike, *Gazeta Zyrtare* nr. 13/05.

<sup>4</sup> Ligji për Radiodifuzion *Gazeta Zyrtare* nr. 100/05.

<sup>5</sup> Anëtarët e Këshillit u emëruan më 18 prill 2006 (shtatë anëtarë) dhe më 23 maj 2006 (dy anëtarë). Anëtarët e Këshillit të Radio-Televizionit të Maqedonisë u emëruan më 23 maj 2006.

<sup>6</sup> Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për radiodifuzion, *Gazeta zyrtare e RM* nr. 10/07.

Strategjia ishte e kritikuar nga ana e disa grupeve të qytetarëve dhe ekspertëve të mediave, të cilët konsideronin se ajo është më tepër një pasqyrë e situatës në radiodifuzionin e Maqedonisë, sesa tentativë për definimin e strategjisë së vërtetë për ndërtimin e një ambienti solid radiodifuziv. Në fund, rregullatori përfshiu disa nga rekomandimet konkrete të ekspertëve, sidomos në lëmin e të drejtave autoriale, digjitalizimit dhe kapaciteteve të Këshillit. Rregullatori e aprovoi Strategjinë, por ajo ishte e refuzuar nga ana e Qeverisë në janar 2008, me arsyetim se ajo ndeshet me politikën e saj të përgjithshme në sferën e telekomunikacionit. Krahas refuzimit nga ana e Qeverisë, Këshilli për Radiodifuzion miratoi planin aksional me hapa konkret për implementimin e Strategjisë në mars të vitit 2008.

Kuvendi dhe Këshilli për Radiodifuzion nuk organizuan debate lidhur me ardhmërinë e RTM-së, lidhur me konsolidimin financiar, modernizimin dhe avancimin e resurseve njerëzore. Në vend të kësaj, disa debate ishin të organizuara nga ana e Qendrës për Zhvillimin e Mediave. Debati i fundit lidhur me punën e RTM-së në pajtim me ligjin e ri për radiodifuzion u mbajt në qershor të vitit 2007.

Që nga shtatori i vitit 2005, Kuvendi kishte miratuar Strategjinë nacionale për zhvillimin e shoqërisë informative për periudhën 2005–2007. Qëllimi kryesor i Strategjisë ishte ndërtimi i një shoqërie informative të qëndrueshme dhe inkluzive, me anë të bashkëpunimit mes sektorëve privat dhe publik, komunitetit akademik dhe personave të tjerë të interesuar. Kjo Strategji bazohet në shtatë shtylla – infrastruktura, e-biznes, e-qeveri, e-arsimim, e-shëndetësi, e-qytetarë dhe rregullativa. Strategjia hasi në përkrahje të të gjitha partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, që ishte rasti i parë një dokument i tillë të ketë një përkrahje të përgjithshme politike. Bashkë me Strategjinë, Qeveria miratoi edhe planin aksional i cili bëri ndarjen e përgjegjësiive lidhur me implementimin e dispozitave të Strategjisë në institucione të ndryshme shtetërore.

Por, Qeveria e re e cila erdhi në pushtet pas zgjedhjeve të vitit 2006, nuk shprehu gatishmëri për implementimin e kësaj strategjie.<sup>7</sup> Sipas vlerësimeve paraprake të AKE-së, vetëm 20 deri më 30% të Planit Aksional janë implementuar, kryesisht për shkak të mjeteve të pamjaftueshme financiare të siguruar nga Qeveria.<sup>8</sup> Edhe pjesa e realizuar ishte rezultat i bashkëpunimit dhe aktiviteteve të organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve.

Strategjia propozoi edhe vendosjen e Agjencisë për shoqëri informative, nën mbikëqyrjen e një këshilli në të cilin do të përfaqësoheshin të gjithë ministrat dhe

<sup>7</sup> VMRO-DPMNE-ja opozitare, parti e qendrës së djathtë, fitoi në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në qershor të vitit 2006.

<sup>8</sup> Një vlerësim për implementimin e këtij plani pritet të publikohet nga ana e AKE-së në të ardhmen e afërt. (intervistë me Bardhyl Jasharin, anëtar i AKE-së dhe drejtor ekzekutivë i Fondacionit Metamorfozis në Shkup, organizatë e specializuar e cila punon në sferën e TKI Shkup 9 prill 2008.

shoqëria civile. Qeveria e re hoqi dorë nga ky plan, duke deklaruar se ajo dëshiron të krijoj ministrinë për teknologji informative. Opozita iu kundërvu këtij plani dhe vazhdoi të përkrah idenë për krijimin e agjencisë. Pas mospjekësorisë së Qeverisë të kaloi dispozitat ligjore në Kuvend m për krijimin e një Ministrie të tillë, ajo vendosi të krijoj funksionin Ministër për teknologji informative pa portofol.

Në prill të Vitit 2007, Ministria e Transportit dhe lidhjeve përgatiti një version pune të Strategjisë Nacionale për komunikacione elektronike dhe teknologji informative. Këshilli Nacional për shoqëri informative, një trup këshillëdhënës i angazhuar për vlerësimin e implementimit të strategjisë, duhet të krijohet deri në fund të majit të vitit 2008. Ende nuk është e qartë se kur Kuvendi do të debatojë dhe votojë lidhur me këtë Strategji.

Ndihma ndërkombëtare nga Njësia për Zhvillimin Mediave pranë misionit të OSBE-së u koncentrua, para së gjithash, në transformimin e servisit shtetëror radiodifuziv në atë publik, si dhe në implementimin e ligjit të ri për radiodifuzion. Monitorimin e implementimit të ligjit, e bën grupi punues në kuadër të QZHM-së.

Çështjet etike të cilat kanë ndikimin e tyre mbi mediat edhe më tutje janë të margjinalizuara. Ka një interes të vogël për debat lidhur me standartet e gazetarëve. Një përjashtim nga kjo është Instituti Maqedonas i Mediave, organizatë joqeveritare e specializuar për trajnimin e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë në medime, e cila në dhjetor 2006 organizoi konferencë me temën gazetaria profesioniste dhe zhvillimi e mediave në Maqedoni, më një theks të veçantë për vetë-rregullimin. Përfundimet nga kjo konferencë e theksuan nevojën e avancimit të respektimit të kodeksit profesional nga ana e gazetarëve si dhe krijimin e instrumenteve të cilat do të sigurojnë një gazetari profesionale.

Në industrinë e mediave, ende nuk eksiton një platformë për mbrojtjen e të drejtave të punësuarve. Lidërshipi i ri i SHGM-së, shoqata më e madhe gazetareske, i zgjedhur në vitin 2007, në krye me kryetarin e ri z. Robert Popovskin, gazetarë i njohur, vendosi një qasje shumë më proaktive. Një arsye tjetër për avancimin e aktiviteteve të SHGM-së është kthimi i donacioneve të huaja gjatë dy viteve të fundit. Sot SHGM-ja në një mënyrë shumë më të kujdesshme, përcjell çështjet të cilat ndikojnë mbi punën e gazetarëve, si për shembull, shoqata zhvillon fushatë kundër korrupsionit mes gazetarëve dhe reagon shumë ashpër lidhur me rastet të përdorimit të gjuhës së urrejtjes.

Në përgatitje e sipër janë tre ligje të reja: për komunikacione elektronike, për ndërmarrjen për transmetim Radiodifuzioni i Maqedonisë. Ligji i fundit parasheh transformimin e MRD-së nga një kompani në pronësi shtetërore, në shoqatë aksionare, me ç'rast privatizimi i tërësishtëm i saj do të përfundojë deri më vitin 2015.

## 1.2 Dispozitat ligjore në UE

Sistemi i pronësisë është relaksuar, edhe pse akoma mungojnë kufizimet precize në lëmin e koncentrimin të mediave. Më tutje, janë të mënjauara të gjitha kufizimet lidhur me investimet e huaja në radiodifuzion. Ligji për radiodifuzionin i vitit 2005, po ashtu përmban dispozita lidhur me transparencën e pronësisë së mediave. Kjo rregullativë është në pajtim me rekomandimet për rregullat për reklamim, teleshopingut dhe sponzorimit.

Pas ndërrimit të sistemit të koncesioneve me atë të licencave, radiot dhe televizionet private filluan procesin e ridefinimit të formateve.<sup>9</sup> Të gjithë radiodifuzerët, privat dhe komercial, adaptuan strukturën e tyre programore që të jetë në pajtim me rregullat, duke përfshirë këtu edhe dispozitat për veprat audio vizuale evropiane, si dhe për muzikë vokale në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët tjera.

---

<sup>9</sup> Këshilli për Radiodifuzion “Rregullore për formatet e serviseve programore të radiove dhe televizioneve”, 30 tetor 2006.

**Tabela 1. Pasqyrë e zhvillimeve në legjislacionit në Maqedoni 2005–2007**

Ligj	RTM	Këshilli për Radiodifuzion	Radiodifuzerët privat
2005 Ligji për Radiodifuzion	<i>Strukturat drejtuese</i> – <i>Ndryshim</i> i sistemit të emërimit të Këshillit të RTM-së i cili është i përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile, ndërsa drejtori ekzekutivë zgjidhet në konkurs të hapur (Këshillin dhe drejtorin ekzekutiv e propozonte dhe zgjidhte Kuvendi) – <i>Ndryshim</i> në strukturën drejtuese të RTM-së, e cila është e përbërë nga Këshilli i RTM-së, bordi drejtues dhe drejtori ekzekutiv. Më parë ishte i përbërë nga këshilli drejtues, këshilli financiar dhe drejtor i përgjithshëm – u zvogëlua numri i anëtarëve të bordit drejtues nga 11 në 7, të cilët i zgjedh Këshilli i RTM-së në bazë të konkursit të hapur. (paraprakisht Këshillin drejtues e propozonin dhe zgjidhnin Kuvendi i RM-së dhe punëtorët e RTM-së.) <i>Programe</i> – TVM-ja është obliguar të emetoj një servis programor në gjuhë maqedonase (TVM1) dhe një servis programor në gjuhë e komuniteteve jo shumicë në Maqedoni (TVM2) – u imponuan kuotat për programe evropiane – u ndalua reklamimi në TVM-në periudhën mes orës 17 dhe 21 – e ndaloi reklamimin politik.	<i>Përmbytje</i> – e kufizoi numrin e mandateve të anëtarëve të Këshillit nga dy në një – rriti numrin e kriterëve për anëtarët e këshillit  <i>Kompetencat</i> – Rriti kompetencat e këshillit nga funksioni “këshillëdhënës” në kompetenca më të mëdha lidhur me licencimin, monitorimin, miratimin e rregullativës nënligjore, sanksioneve dhe pjesëmarrjes në përgatitjen e projekteve ligjore.  <i>Transparenca</i> – Obligoi këshillin për radiodifuzion të organizojë takime publike me palët e interesuara, së paku një herë në tre muaj, për t’iu mundësuar paraqitjen e mendimeve lidhur me çështje nga sfera e radiodifuzionit. – Përmban dispozita të cilat duhet t’u mundësojnë aplikantëve të fillojnë procedurë gjyqësore në rast të pakënaqësisë nga vendimet e Këshillit.	<i>serviset</i> – Rritje e limitit minimal për programin ditor.  <i>Sektorë të rinj</i> – prezantoi konceptin e ri për sektor joprotitabil radiodifuziv – prezantoi konceptin e ri të emetimit rajonal (krahas atij lokal dhe kombëtar) – ndërroi sistemin e koncesioneve me atë të licencave  <i>Pronësi</i> – largoi të gjitha kufizimet lidhur me investimet e huaja në radiodifuzion. – ndryshoi dispozitat për koncentrimin e pronësisë, duke lejuar radiodifuzerët kombëtar të kenë deri më 50% të kapitalit në një kompani radiodifuzive tjetër (nga 25% në të kaluarën)  – definoi koncentrimin e pronësisë tek radiot dhe televizionet të cilat po ashtu posedojnë: • kompani radiodifuzive mbi numrin e caktuar ligjor; • botues i cili boton gazetë ditore në territorin të cilin e mbulon radiodifuzeri; • agjenci lajmesh; • agjenci të reklamimit, kompani për hulumtime të tregut dhe opinionit publik, distributor i radiodifuzionit, producent filmik dhe kompani të telekomunikacionit.

Plotësimi i Ligjit për radiodifuzion nga viti 2007	<i>Strukturat drejtuese</i>		
	– ndryshoi pozitën e drejtorit ekzekutiv nga një person në dy persona me zëvendësit e tyre. – Lejoi emërimin e shtetasve të huaj në pozita udhëheqëse në MTR. <sup>10</sup>		

### 1.3 Tregu radiodifuziv

Tregu i mediave elektronike është i përbërë nga 114 radiodifuzerë, 52 televizione dhe 62 radio stacione. Stacionet publike tani përbëhen nga tre kanalet televizive dhe 5 radio kanalet e RTM-së.<sup>11</sup> Sektori komercial përbëhet nga: tetë stacione kombëtare (pesë televizione dhe tre radiostacione); 27 stacione me mbulim rajonal (11 TV dhe 16 radio); dhe 79 radiodifuzerë lokal (36 TV dhe 43 radio stacione). Në tregun kabllor funksionojnë 118 operatorë, të obliguar me ligj ta informojnë Agjencinë për Komunikacione Elektronike për funksionimin e tyre. Vetëm 53 operatorë kanë plotësuar këtë obligim. Këshilli për radiodifuzion urdhëroi të tjerët të ndërpresin punën.<sup>12</sup>

Konkurenca në nivel kombëtar është shumë e ashpër. Dominojnë stacionet komerciale me 95 për qind të tregut të reklamave (A1 TV – 51%; Kanal 5 – 21.5%; dhe Sitel TV 17.1%). Tre kanalet e MTV-së kontrollojnë vetëm 0.9% nga tregu i kombinuar. Stacionet komerciale kombëtare, kanë po ashtu pozitë udhëheqëse nga aspekti i shikueshmërisë. (shiko tabelën 2).

<sup>10</sup> Kjo dispozitë më vonë u pezullua nga ana e Gjykatës Kushtetuese. (shiko Seksionin 3.1 *Legjislacioni dhe politikat e SR-sëP*).

<sup>11</sup> Në pajtueshmëri me Ligjin për radiodifuzion, Këshilli për Radiodifuzion vendosi se 29 radio stacionet publike lokale duhet të transformohen në radiodifuzerë komercial.

<sup>12</sup> “Raporti i Këshillit për Radiodifuzion të RM-së për periudhën nga 01.01.2007 deri më 31.12.2007”, Shkup mars 2008, mund të shihet në faqen e internetit: [http://www.srd.org.mk/WEBStorage/Files/IZVESTAJ\\_POSLEDEN.doc](http://www.srd.org.mk/WEBStorage/Files/IZVESTAJ_POSLEDEN.doc) (në vazhdim të tekstit Këshilli për Radiodifuzion, raporti vjetor 2007).

**Tabela 2. Shikueshmëria e TV kanaleve udhëheqëse në vitin 2007**

Kanali	Pjesa nga publiku (në përqindje)
A1	23.7
Sitel	12.3
TVM1	9.4
Kanal5	7.6
Telma	3.9
MTV2	2.3
AlsatM	1.5
Kanalet Satelitore	23.2
Kanale të tjera	15.3

Burim: SMMRI<sup>13</sup>

Numri më i madh i radio stacioneve dhe televizioneve lokale mbijetojnë. Edhe pse më herët mbijetonin me donacione të huaja, që nga viti 2002 donatorët ndërprejnë ndihmën financiare të këtyre stacioneve, duke pohuar se ndihma nuk ka përmirësuar situatën. Stacionet që funksionojnë në mjedise të vogla dhe të pazhvilluara ballafaqohen me kushte më të rënda pune.

## 2. REGULLATIVA DHE LICENCIMI NË SEKTORIN TELEVIZIV

### 2.1 Organet rregullatore dhe kornizat

Sipas Ligjit për radiodifuzion të viti 2005, Këshilli për Radiodifuzion, organ ky i pavarur, fitoi kompetenca më të mëdha, sidomos në kuptimin e dhënies dhe marrjes së licencave radiodifuzive, implementimin e legjislacionit dhe miratimin e strategjive dhe politikave.

Institucionet kryesore në lëmin e radiodifuzionit janë Këshilli për Radiodifuzion, Agjencia për Komunikacion Elektronik, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministria e Kulturës. Ministria e Transportit dhe Lidhjeve është përgjegjëse për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e rrjeteve dhe pajisjeve të radiodifuzionit dhe të transmetimit. AKE jep lejen për përdorimin e frekuencave dhe bën mbikëqyrjen lidhur me përdorimin e tyre. Mbikëqyrja e implementimit të dispozitave lidhur me të

<sup>13</sup> Strategic Marketing and Media Research (SMMRI), “Nevojat programore të publikut televiziv në Republikën e Maqedonisë” qershor 2007.

drejtat autoriale, në vitin 2007 u transferua nga Ministria e Kulturës në inspektoratin e tregut, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë. Dispozitat për përdorimin e gjuhës maqedonase në radiodifuzion janë nën kompetencat e Ministrisë së Kulturës.<sup>14</sup>

Një rol i rëndësishëm i takon Këshillit për Radiodifuzion, “si një institucion i pavarur joprofitabil me autorizime publike dhe kompetenca në lëmin e kryerjes së veprimtarisë radiodifuzive”. Ai ka misionin të sigurojë “lirinë dhe pluralizmin e të shprehurit, ekzistimin e llojllojshmërisë, pavarësisë dhe autonomisë së mediave si dhe zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të veprimtarisë radiodifuzive dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve në radiodifuzion”.<sup>15</sup>

Për dallim nga periudha para vitit 2005, kur mundej të rizgjidheshin, nëntë anëtarët e Këshillit tani mund të shërbejnë vetëm një mandat. Një nënkryetar dhe një anëtar i Këshillit janë shqiptar, ndërsa një anëtarë është boshnjak. Mandati i anëtarëve zgjat gjashtë vjet.<sup>16</sup> I zgjedh Kuvendi, në bazë të nominimit nga:

- Konferenca Interuniversitare, organ në të cilin marrin pjesë të gjitha universitetet shtetërore në Maqedoni (tre kandidatë);
- Komisioni për zgjedhje dhe emërimet i Kuvendit të RM-së (tre kandidatë);
- Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (dy kandidatë);
- Akademia e Shkencave dhe Arteve (një kandidatë).<sup>17</sup>

Mandatet nuk janë të përbashkëta. Në përbërjen e parë të Këshillit për Radiodifuzion, tre anëtarë u zgjodhën për periudhë dyvjeçare, tre për periudhë katërvjeçare, ndërsa të tjerët për periudhë gjashtëvjeçare.

Kuvendi nuk mund në mënyrë të drejtpërdrejtë të shkarkojë anëtarë të Këshillit, por vetëm në bazë të kërkesës së rregullatorit, në rast se shumica e anëtarëve të Këshillit kërkojnë nga Kuvendi të ndër marrë një hap të tillë. Kjo ulje e kompetencave të Kuvendit konsiderohet si një hap pozitiv, në drejtim të forcimit të pavarësisë së institucionit rregullativ. Ligji për Radiodifuzion i vitit 2005 rriti numrin e kushteve, me të cilat një person mund të konsiderohet si i papërshtatshëm për anëtar i Këshillit.<sup>18</sup> Personat të cilët punojnë në sektorin radiodifuziv, siç është industria e reklamave, komunikacioni elektronik, prodhimi dhe shitja e mjeteve për emetim, nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit. Në të njëjtën kohë, nuk mund të zgjidhen persona, farefisi i afërt i të cilëve është në organet drejtuese të organizatave radiodifuzive, si dhe persona

<sup>14</sup> Ligji për Radiodifuzion neni 164–165.

<sup>15</sup> Ligji për Radiodifuzion neni 21.

<sup>16</sup> Ligji për Radiodifuzion neni 28 и 30.

<sup>17</sup> Ligji për Radiodifuzion neni 26-27.

<sup>18</sup> OSI/Republic of Macedonia, p. 1,179.



të cilëve u është shqiptuar masa ndalesë për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive për një kohë më të gjatë se gjashtë muaj.<sup>19</sup>

Ligji i vitit 2005 i jep Këshillit shumë më tepër kompetenca. Tani Këshilli mundet të:

- Miratojë dhe implementoj Strategjinë për zhvillimin e Radiodifuzionit;
- Vendosë për dhënien, anulimin dhe vazhdimin e licencave radiodifuzive;
- Koordinojë dhënien dhe shfrytëzimin e frekuencave për radiodifuzion në bashkëpunim me AKE-un;
- Bën mbikëqyrjen mbi punën e radiodifuzerëve dhe jep certifikata për regjistrimin e serviseve programore radio dhe televizive të rriemtuara me anën e rrjeteve publike të komunikacionit;
- Të miratojë vendime, rregulla, konkluzat dhe rekomandime për implementimin e legjislacionit;
- Ndërmerr masa ligjore kundër radiodifuzerëve dhe operatorëve kabllor, të cilët nuk I plotësojnë obligimet ligjore;
- Merr pjesë në përgatitjen e legjislacionit relevant, rregullativës dhe akteve të tjera;
- Miratojë listën e ngjarjeve të rëndësishme me interes publik;
- Miratojë dhe implementoj masa në përputhje me ligjin;
- Informojë organet kompetente për çështje nga lëmi I të drejtave autoriale, kur ekziston dyshimi për shkeljen e tyre;
- Të shqyrtojë kërkesat dhe ankesat për programet radio-televizive të dorëzuara nga ana e qytetarëve;
- Informojë opinionin për vendimet e miratuara dhe masat e ndërmarra;
- Të iniciojë procedura për kundërvajtje dhe penale.<sup>20</sup>

Pas miratimit të Ligjit për Radiodifuzion në vitin 2005, Këshilli për Radiodifuzion propozoi plan për implementimin e ligjit. Njëkohësisht, Këshilli miratoi edhe një numër të akteve nënligjore, që kanë të bëjnë me:

- ngjarjet e rëndësishme me interes publik;
- mbulimi i drejtë i zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2006;

---

<sup>19</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 25.

<sup>20</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 37.

- të drejtë për informim të shkurtër;
- rruajtjen e identitetit kulturor;
- listën e formateve të stacioneve televizive dhe radiove;
- veprave evropiane audio vizuale;
- mbrojtjen e të rinjve nga radiodifuzerët;
- rruajtjen dhe distribuimin e programeve radiodifuzive;
- Standartet dhe parametrat teknik për punën në studiot e radiodifuzerëve;
- Klasifikimi i radio dhe TV programeve.<sup>21</sup>

Transparenca është e siguarur më mundësinë e qasjes publike në punën e Këshillit. Vendimet e Këshillit publikohen, ndërsa mbledhjet janë të hapura, përveç kur diskutohet për informata të klasifikuara.<sup>22</sup> Këshilli për Radiodifuzion është i obliguar ti publikojë (në formë elektronike dhe në faqen e tij të internetit) informatat për konkurset e hapura për licenca radiodifuzive, numrin e kandidatëve të cilët marrin pjesë në konkurse, si dhe për Vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve të tij. Këshilli është po ashtu i obliguar të informojë publikun për punën e vet, nëpërmjet mjeteve të informimit, së paku një herë në tre muaj. Deri më tani, trupi rregullator publikonte informata të tilla vetëm në faqen e vet të internetit.

Sipas Ligjit për Radiodifuzion të vitit 2005, Këshilli për Radiodifuzion është i obliguar të organizojë takime publike më palët e interesuara, së paku një herë në tre muaj, për t'iu mundësuar ti paraqesin mendimet e veta lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me radiodifuzionin.<sup>23</sup> Deri më tani janë mbajtur tre takime të tilla. Në të parën u diskutua për reformën e radio stacioneve publike, e dyta u fokusua në çështjen e mbrojtjes së të rinjve nga përmbajtjet programore të cilat mund keq të ndikojnë në zhvillimin e tyre, dhe e treta kishte të bëjë me strategjinë radiodifuzive.

Këshilli për Radiodifuzion duhet të organizojë më tepër debate të këtilla, për të siguarur transparencën e sektorit. Këshilli edhe më tutje përgjigjet për punën e vet para

<sup>21</sup> Këto akte nënligjore janë në faqen e internetit të Këshillit për Radiodifuzion, <http://www.srd.org.mk>.

<sup>22</sup> Ligj për radiodifuzion neni.33. Ligji nuk jep definimin e terminit “informata të klasifikuara”. “Sipas nenit 49 nga rregullorja e Këshillit për Radiodifuzion të 19 qershorit të vitit 2006, Këshilli i definon informatat e klasifikuara si fshehtësi shtetërore, ushtarake apo afariste. (Rregullorja e Këshillit për radiodifuzion dhe konkluzat për plotësimin e Rregullores nr. 02-1643/3, miratuar në mbledhjen e 15-të të Këshillit më 19-të qershor 2006. Arsyetimi i kësaj dispozite është mes të tjerash se, duhet të mbrohen të dhënat e tilla për radiodifuzerët, për shkak se në rast të publikimit, mund të kenë ndikim në konkurrencën. Në formën e tanishme kjo dispozitë nuk i mbron radiodifuzerët.

<sup>23</sup> Ligji për Radiodifuzion, neni 33.

Kuvendit, kujt i dorëzon raport vjetor. Nëse Kuvendi gjen parregullsi në raportin, mund të kërkojë nga Këshilli të dorëzojë një raport të ri financiar në afat prej 60 ditëve.<sup>24</sup>

Këshilli bën mbikëqyrjen e respektimit të kushteve dhe kufizimeve ligjore lidhur me programin, si dhe të kushteve të licencës.<sup>25</sup> Ligji për radiodifuzion i vitit 2005 parasheh disa masa në rast të shkeljes së dispozitave ligjore dhe kushteve të licencës.

**Tabela 3. Kompetencat e reja të Këshillit për radiodifuzion për shqiptimin e masave ndëshkuese**

Vërejtje me shkrim	Të gjitha shkeljet e dispozitave ligjore, të akteve nënligjore të Këshillit dhe kushteve të licencës.
Vërejtje të cilat duhet të publikohen nga ana e radiodifuzerit.	Shkelje e përsëritur e dispozitave ligjore nga ana e radiodifuzerit.
Ndalesë kohore (nga një deri më shtatë ditë) për emetim të reklamave dhe teleshoppingut.	Shkelje e dispozitave për standarte programore, reklamimit, teleshoppingut dhe sponsorizimit
Ndalesë kohore për emetim për periudhë kohore deri më tre muaj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>– shkelje e përsëritur e dispozitave ligjore nga ana e radiodifuzerit edhe pas shqiptimit të tri masave paraprake.</li> <li>– Emetim i përmbytjeve të cilat ftojnë për ndryshim të dhunshëm të rendit kushtetues të shtetit ose agresion ushtarak;</li> <li>– Emetimin e përmbytjeve të cilat iniciojnë urrejtjen nacionale, racore dhe fetare;</li> <li>– Emetimi i përmbytjeve pornografike, dhunës së tepruar, ose përmbytjeve të cilat mund seriozisht të shkaktojnë dëmtime të rënda në zhvillimin fizik, mental dhe moral të rinisë dhe të fëmijëve.<sup>26</sup></li> <li>– Lëshim i radiodifuzerit të publikojë raport për aktivitetet e tij (duke përfshirë ndryshimet në strukturën pronësore, organet drejtuese, burimet e financimit dhe ndryshime statutare), në së paku një gazetë ditore dhe në programet e tij.<sup>27</sup></li> </ul>

**Burim:** hulumtime të ISHH

Në vitin 2006, Këshilli për radiodifuzion shqiptoi 16 vërejte me shkrim (tetë ndaj televizioneve dhe tetë ndaj radiostacioneve). Vërejtjet e përmendura (16), ishin të

<sup>24</sup> Ligji për Radiodifuzion, neni. 35.

<sup>25</sup> Ligji për Radiodifuzion, neni. 163.

<sup>26</sup> Ligji për radiodifuzion, nenet 69-70.

<sup>27</sup> Ky obligim nuk është plotësuar nga asnjë radiodifuzer dhe Këshilli për Radiodifuzion asnjëherë nuk ka ndërmarrë sanksione. Dispozita ka një rëndësi esenciale për transparencën e pronësisë, një ndër çështjet më kontroverze në radiodifuzionin e Maqedonisë.

shqiptuara për programet radiodifuzive të cilat nuk ishin në përputhje me kushtet e licencës, për shkeljen e parimeve programore, shkaktimin e jotolerancës nacionale, fetare dhe gjinore, emetimin e programeve pornografike, tejkalimin e kufizimeve për reklama dhe për emetimin e programeve pa të drejta autoriale. Dy vërejtjet më të rëndësishme për publikim<sup>28</sup> ishin të shqiptuara për emetim të sërishëm të përmbajtjeve pornografike dhe të tejkalimit të kufizimeve për reklamim.<sup>29</sup>

Në vitin 2007, Këshilli për Radiodifuzion shqiptoi 166 sanksione radiodifuzerëve privat dhe shtatë sanksione kundër RTM-së.<sup>30</sup>

Ekzistonte plani i Qeverisë për bashkimin e dy trupave rregullatore, Këshillit për Radiodifuzion dhe AKE-së, gjë që mund të rrezikonte në mënyrë serioze pavarësinë e tyre. Hapi ishte i arsyetuar si tentim për konsolidimin e tregut radiodifuziv dhe atij të komunikacionit elektronik,<sup>31</sup> por ekzistonte edhe frika te disa persona se bëhet fjalë për tentim të kthimit të kontrollit politik. Teksti i ri ligjor për komunikacionin elektronik, i përgatitur në vitin 2007, propozonte bashkimin e dy trupave në një, ky organ do të quhej Agjenci për radiodifuzion dhe komunikime elektronike. Këshilli pesëanëtarësh i kësaj agjencie do të nominohej dhe ndërrohej nga ana e Komisionit Kuvendor për zgjedhje dhe emërimë. Nën presionin e madh të organizatave që veprojnë në sferën e mediave në Maqedoni dhe në bazë të rekomandimeve të UE-së për implementimin e legjislacionit aktual,<sup>32</sup> Qeveria u tërhoq nga planet. Edhe pse bashkimi është i mundshur në të ardhmen, observatorët e pavarur konsiderojnë se do të ishte e papranueshme për shkak se të dy trupat janë posa të zgjedhura dhe nuk kishin kohë për t'u dëshmuar.<sup>33</sup>

<sup>28</sup> Radiodifuzerët janë të obliguar me ligj të publikojnë vërejtje e tilla (Ligji për radiodifuzion neni 38). Por, Këshilli për Radiodifuzion nuk ka bërë monitorimin, për të konstatuar se a kanë vepruar radiodifuzerët në pajtim me ligjin. Këshilli për Radiodifuzion në mënyrë permanente publikon të gjitha shkeljet në faqen e vet të internetit.

<sup>29</sup> Raport i Këshillit për Radiodifuzion i RM-së për periudhën 1.1.2006 deri më 31.12.2006 (në vazhdim të tekstit Këshilli për Radiodifuzion, raporti vjetor 2006).

<sup>30</sup> Këshilli për Radiodifuzion, raporti vjetor 2007.

<sup>31</sup> Verçe Georgievska, "Mediat frikohen nga ligji i ri për radiodifuzion" Utrinski vesnik, 31 mars, viti 2007.

<sup>32</sup> Commission of the European Communities, The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2007, Progress Report Accompanying the communication from the Commission to the European Parliament and the Council. Enlargement Strategy and Main Challenges 2007-2008, COM (2007) 663 Final, Brussels, November 6, 2007, SEC (2007) 1432 (në tekstin e mëtuajtshëm 2007 EU Annual Report Republic of Macedonia).

<sup>33</sup> Intervistë me Bardhyl Jasharin, op. cit.

## 2.2 Sistemi i licencave

Sipas ligjit për radiodifuzion të vitit 2005, Këshilli për Radiodifuzion është përgjegjës për dhënien, anulimin dhe ripërtërirjen e licencave radiodifuzive.<sup>34</sup> Më parë, këto detyra i ka pasur Qeveria, edhe pse me propozim të Këshillit. Të gjitha rregullat dhe procedurat për licencim janë të përshkruara në Ligj. Kështu që, Këshilli për Radiodifuzion duhet të shpall tender për dhënien e licencave.<sup>35</sup> Më vonë, të sjellë vendim në bazë të kriterëve në vijim:

- Natyra e servisit programor;
- Llojllojshmëria gjenetike dhe tematike e përmbajtjeve programore;
- Përqindje e programit ditor të përgjithshëm, të prodhuar në mënyrë burimore, në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e pakicave etnike;
- Relacioni i programeve të cilat mbulojnë ngjarje dhe raste të rëndësishme për rajonin gjeografike të cilin mbulojnë programet radiodifuzive;
- Relacioni i veprave audio vizuale evropiane dhe programeve të cilat promovojnë zhvillimin dhe rruajtjen e kulturës nacionale;
- Kërkesa teknike për prodhim dhe emetim të programeve në pajtim me standartet e caktuara;
- Objekti dhe mjetet;
- Numri dhe struktura e resurseve njerëzore;
- Kapacitetet financiare;
- Kontributi i planifikuar drejt promovimit të pluralizmit në veprimtarinë radiodifuzive.<sup>36</sup>

Referencat për llojllojshmëri dhe pluralizëm, si dhe të programeve evropiane, janë të reja në ligjin e vitit 2005). Që nga momenti kur Këshilli për Radiodifuzion do të vendos se kush do të marrë licencë, AKE jep licencën teknike për përdorimin e frekuencës. Hapi i fundit është i Këshillit për Radiodifuzion, i cili ia jep licencën bazë të certifikatës për regjistrim të dhënë nga AKE. Sipas Ligjit për radiodifuzion të vitit 2005, aplikantët të cilët janë të pakënaqur nga vendimi i Këshillit, kanë të drejtë ligjore të ankesës.<sup>37</sup> Më parë një e drejtë e tillë nuk ekzistonte.

---

<sup>34</sup> Ligji për radiodifuzion neni. 37.

<sup>35</sup> Ligji për radiodifuzion neni. 43.

<sup>36</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 51.

<sup>37</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 54-55.

Sistemi për licencim aplikohet për të gjitha mediat elektronike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Ligji për radiodifuzion i viti 2005 ndryshoi minimumin e emetimit ditor të programit nga ana e radiodifuzerëve. Në nivel kombëtar, ata janë të obliguar të emetojnë së paku 18 orë radio program në ditë dhe së paku 12 orë program televiziv. Në nivel rajonal, radio stacionet duhet të emitojnë së paku 12 orë program në ditë, ndërsa televizionet duhet të emitojnë së paku 10 orë program në ditë. Stacionet lokale janë të obliguara të emitojnë së paku 10 orë program, ndërsa televizionet lokale së paku gjashtë orë program në ditë.<sup>38</sup>

Licenca radiodifuzive duhet të përmban të dhëna për bartësin e licencës, mjetet teknike për emetim, rajonin gjeografik i cili do të mbulohet me shërbimin, lokacionin e mjeteve teknike, afatin e fundit për fillimin e emetimit, kohëzgjatjen e licencës, etj. Licenca ka një kohëzgjatje prej nëntë vitesh, nuk mund të transferohet në persona të tretë dhe për të paguhet një çmim i caktuar.<sup>39</sup> Dispozitat e reja ligjore janë duke u zbatuar sipas parashikimeve. Gjithsej 115 nga 123 radiostacionet dhe televizionet private, iu përgjigjën thirrjes së Këshillit për Radiodifuzion që të kthejnë të drejtat e koncesionit dhe ndërrimin e tyre me licencat radiodifuzive. Tetë radiodifuzerëve të tjerë që nuk e bënë këtë do t'iu merren koncesionet.

Eliminimi i koncesioneve në favor të licencave radiodifuzive, sipas parashikimeve, duhet të zvogëlojë në mënyrë të dukshme ndikimin qeveritar në rregullimin e radiodifuzionit. Këshilli për Radiodifuzion u bë organi i vetëm i angazhuar për dhënien, marrjen dhe vazhdimin e licencave. Sipas ligjit paraprak, në bazë të propozimit të Këshillit për Radiodifuzion, Qeveria radiodifuzervë iu mundësonte në bazë të koncesionit përdorimin e frekuencave, që konsiderohej si një influencë e drejtpërdrejtë në çështjet e radiodifuzionit.

Gjithsej 114 radio dhe televizione private morën licenca. Ata përfshijnë:

- 8 radiodifuzerë nacional (5 TV dhe 3 radio stacione);
- 27 radiodifuzerë rajonal (11 TV dhe 16 radiostacione);<sup>40</sup>
- 79 radiodifuzerë lokal (36 TV dhe 43 radiostacione).

Problemi më serioz është implementimin i legjisllacionit të ri në kohën e harmonizimit të “dispozitave kaluese dhe përfundimtare”.<sup>41</sup> Për shembull, transferimi i të drejtave të

<sup>38</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 72.

<sup>39</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 56, 58 и 60.

<sup>40</sup> Sipas Ligjit për radiodifuzion (neni 4) të gjitha stacionet radio dhe televizione të cilat emetojnë program në territorin e qytetit të Shkupit, bëhen radiodifuzer rajonale, për shkak se qyteti i Shkupit dhe rrethina konsiderohen si rajon i posaçëm.

koncesionit në atë të licencave paraqiste një vështirësi për Këshillin. Ligji obligon rregullatorin të kompletojë procesin në afat prej 18 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit.<sup>42</sup> Kërkesa e Këshillit nga prilli i vitit 2007 për tërheqjen e koncesioneve për 23 radio stacione dhe televizione, të cilët nuk kishin paguar taksën për përdorimin e licencave, ende nuk është zgjidhur.<sup>43</sup> Dy muaj më vonë rregullatori iu dha licenca këtyre stacioneve.

Në këtë moment është në rrjedhë e sipër regjistrimi i pakove programore në tregun e televizioneve kabllorë.<sup>44</sup> Nga 118 operatorë lokal, vetëm 53 kanë regjistruar aktivitetet te Këshilli për Radiodifuzion. Kërkesat e tjera u refuzuan kryesisht për shkak të mungesës së vërtetimit nga Ministria e Kulturës për respektimin e të drejtave autoriale.<sup>45</sup> Priten investime të huaja në rrjetat kabllor. Kompania bullgare Kejbëlltell, me kapital amerikan, bleu 13 operatorë kabllor në Shkup, Kumanovë, Veles dhe Tetovë. Flitet se janë në negociata për akvizicione të reja, si pjesë e një procesi më të gjerë të konsolidimit të sektorit kabllor. Përveç shërbimeve televizive, kompania planifikon të fillojë edhe me shërbime të tjera siç janë broadband interneti dhe shërbimet e telefonit. Po ashtu, është në plan blerja e operatorëve të tjera kabllor.<sup>46</sup>

Sipas kritikëve lokal të mediave, në vend të fokusimit në implementimin e legjislacionit të ri, Këshilli për Radiodifuzion duhej të humbte kohë në mbrojtjen prej presioneve nga jashtë. Në dy vitet e kaluara trupi rregullator miratoi një sërë aktesh nënligjore dhe rregullore, por implementimi i tyre është i ngadalshëm. Vitin e kaluar, Këshilli ishte mjaftë më aktiv në implementimin e Ligjit dhe në lëmin e monitorimit të sektorit.

Parashihen probleme serioze gjatë kalimit në teknologjinë digjitale, proces i cili më ka filluar. Në shkurt të vitit 2008, edhe përkundër mungesës së kornizës ligjore dhe politike, shteti dëshiroi të publikoi tenderin për multipleksët digjital të cilat do ti bartin

<sup>41</sup> “Dispozitat kaluese dhe përfundimtare” (nenet 168-180) definojnë periudhën e harmonizimit të Ligjit për radiodifuzion si periudhë në të cilën duhet të emërohen anëtarët e ri të Këshillit për Radiodifuzion, Këshillit të RTM-së dhe bordit drejtues të RTM-së, bashkë me drejtorin ekzekutivë dhe zëvendës drejtorin e RTM-së, në të cilën kontratat për koncesione duhet të zëvendësohen me licenca dhe të miratohet Strategjia nacionale për zhvillimin e radiodifuzionit.

<sup>42</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 172.

<sup>43</sup> Këshilli për radiodifuzion kërkoi nga Qeveria të anuloi të drejtat e koncesioneve të këtyre radio stacioneve më 19 shkurt të vitit 2007, Qeveria e informoi Këshillin për Radiodifuzion se vendimi anulohet. Këshilli tërhoqi kërkesën më 3 maj 2007, me arsyetim se procedura e licencimit është në përfundim, kështu që është vendosur t’iu ndahen licenca radiodifuzive të gjithë palëve të gjithat i plotësojnë kushtet ligjore.

<sup>44</sup> Sipas Ligjit për radiodifuzion (neni 107) operatorët kabllor duhet të regjistrojnë serviset e veta programore si pako te Këshilli për radiodifuzion. Po ashtu, janë të obliguar dorëzojnë vërtetim nga Ministria e Kulturës, se i kanë respektuar drejtat autoriale.

<sup>45</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 109.

<sup>46</sup> Verçe Georgievska, “Tetë operatorë kabllor, formuan konzorcium”, *Utrinski vesnik*, 11 qershor 2007.

programet radiodifuzive. Onnet, operator i telekomunikacionit në pronësi Sllovene, konsiderohet favorit në marrjen e kontrollit të tre nga katër multipleksët, të ofruar në fazën e parë të tranzicionit. Multipleksi i katërt, sipas parashikimeve, duhet të jetë i rezervuar për MRD-në dhe do të bartë programet e radiodifuzerit publik. Tenderi u anulua, dhe është jo aq e mundshme që ai të përfundojë në qershor të vitit 2008. Në këtë moment AKE-u punon lidhur me listën e kritereve për pjesëmarrje në tender. Organizatat e shoqërisë civile, si është QZHM-ja, thonë se një proces i rëndësishëm si është ky, duhet ti paraprijë një debat i gjerë, me pjesëmarrje të palëve të interesuara, për modelin rregullator i cili më së shumti i përgjigjet një ambienti digjital, sidomos në lëmin e rregullimit të radiodifuzionit digjital tokësor.

### **3. RREGULLATIVA DHE MENAXHIMI ME SERVISIN TELEVIZIV PUBLIK (SRP)**

#### **3.1 Legjislacioni dhe politikat e SRP-së**

Ligji për Radiodifuzion i vitit 2005 solli disa ndryshime të rëndësishme në RTM, veprimtaria e së cilës më nuk përcaktohet me ligj të veçantë.<sup>47</sup> Struktura menaxheriale e RTM-së e cila përbëhet nga Bordi drejtues, këshilli mbikëqyrës financiar dhe drejtori ekzekutivë, tani përbëhet nga Këshilli i RTM-së, Bordi Drejtues dhe Drejtori Gjeneral. Sipas amendamenteve të miratuara në vitin 2007, shtetas i huaj, po ashtu mund të jetë i emëruar në pozitën e Drejtorit gjeneral. Më vonë, atë vit, Gjykata kushtetuese kontestoi kushtetutshmërinë e kësaj dispozite dhe e shpalli kundërkushtetuese, duke konsideruar se emërimi i shtetasit të huaj në udhëheqësin i institucioneve publike është kundër interesave nacionale të Maqedonisë.

Sistemi i RTM-së përbëhet nga tre kanale TV dhe katër radio kanale. Ligji për radiodifuzion i vitit 2005, obligon TVM-në të emetojë një servis programor në gjuhën maqedonase (TVM1) dhe një servis programor në gjuhën e komuniteteve joshumicë në Maqedoni (TVM2). Paraprakisht, TVM2 emetonte programe zbavitëse dhe sportive. Kanali i tretë, i cili emetonte programe të pakicave, u transformua në Kanal Kuvendar dhe emetonte vetëm programe nga Kuvendi i Maqedonisë. TVM-ja filloi të emetonte programe në pajtim me formatin e ri në fillim të vitit 2005. Radioja e Maqedonisë (MR) emetonte dy kanale (MR1 dhe MR2) në gjuhën maqedonase dhe një kanal

---

<sup>47</sup> Aktivitetet e RTM-së, paraprakisht ishin të rregulluara me Ligjin për themelimin e ndërmarrjes publike radio-televizioni I Maqedonisë, gazeta zyrtare e RM-së nr.6/98 dhe me Ligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjin për themelimin e ndërmarrjes publike radio-televizioni I Maqedonisë gazeta zyrtare e RM-së nr.78/04. Dispozitat nga këto ligje ishin të inkorporuara në Ligjin për radiodifuzion të vitit 2005 dhe ndryshimet në vitin 2007.



(MR3) në gjuhën e komuniteteve joshumicë. RTM-ja po ashtu emeton nga një kanal radio dhe televiziv (MKTV) nëpërmjet satelitit.<sup>48</sup>

Me Ligjin për radiodifuzion të vitit 2005 përcaktohen edhe standartet profesionale redaktuese të cilat duhet të respektohen në programet e RTM-së.

Lidhur me këtë, RTM-ja është e obliguar të prodhoj dhe emetojë programe të interesit publik, të cilat i pasqyrojnë dallimet shoqërore dhe kulturore në Maqedoni dhe janë të përmbajtjes informative, kulturore, arsimore, shkencore dhe zbatimëse. Që të plotësojë këtë mision RTM-ja duhet:

- të sigurojë mbrojtje të programeve nga çfarëdo ndikimi të qeverisë, organizatave politike dhe qarqeve ekonomike;
- të zhvillojë dhe planifikojë skemë programore e cila është në interes të publikut të përgjithshëm dhe të prodhojë dhe emetojë programe për të gjitha segmentet e shoqërisë, pa diskriminim;
- të sigurojë se programet do të jenë reflektim t ideve të ndryshme, do të kujdesen për identitetin kulturorë të komuniteteve në vend, do të respektojnë dallimet kulturore dhe fetare dhe do të promovojë kulturë të dialogut publik me qëllim të avancimit të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe tolerancës në favor të marrëdhënieve më të mira mes komuniteteve në një ambient multietnik dhe multikulturor;
- të kujdeset, të promovojë dhe zhvilloj të gjitha format e veprave nacionale audio vizuale të cilat kontribuojnë në zhvillim e kulturës maqedonase si dhe të afirmimit ndërkombëtarë të identitetit kulturorë maqedonas;
- të kujdeset dhe të zhvillojë standartet gjuhësore e të gjithë komuniteteve në RM;
- të promovojë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, institucioneve dhe vlerave demokratike, të dinjitetit, reputacionit dhe nderit të njeriut;
- të zhvillojë, planifikoj dhe emetojë programe, emisione informative dhe lajme të dedikuara personave me dëgjim të dëmtuar;
- të sigurojë kohë të barabartë pa pagesë gjatë fushatave zgjedhore për emetimin e programeve të prodhuara nga partitë politike, koalicioneve dhe kandidatëve të cilët marrin pjesë në zgjedhjet e përgjithshme, lokale dhe presidenciale, në pajtim me rregullat e prezantimit në media;<sup>49</sup>
- të sigurojë lajme rajonale dhe lokale;

<sup>48</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 117.

<sup>49</sup> Rregullat zgjedhore janë të përcaktuara na Ligjin për zgjedhje, *Gazeta zyrtare e RM-së nr. 40/06*.

- të krijojë kushte për përdorimin dhe zhvillimin e standardeve moderne teknike dhe teknologjike në prodhimin dhe emetimin e programeve, dhe të përgatisë plan për tranzicionin digjital në pajtueshmëri me Strategjinë nacionale për zhvillimin e radiodifuzionit;
- të ruan dhe arkivon materialet e saj të incizuara, radio dhe televizione, dhe dokumentet si pjesë e trashëgimisë audio vizuale të RM-së.<sup>50</sup>

RTM-ja po ashtu është e obliguar, gjatë procesit të prodhimit dhe emetimit të programeve të saj, “ti përmbahet principeve profesionale dhe të sigurojë qasje të njëjtë për interesat e ndryshme në shoqëri, ti kushtohet lirisë dhe pluralizmit të shprehjes së mendimit publik, si dhe të pamundësojë çfarëdo lloj të jotolerancës racore, fetare, nacionale, etnike”.<sup>51</sup>

Ligji i vitit 2005 përcakton se, për herë të parë, TVM 1 dhe TVM 2 duhet të emetojnë vepra audio vizuale evropiane, dhe atë së paku 60 për qind nga koha e përgjithshme vjetore e emetimit, duke i përjashtuar lajmet, ngjarjet sportive dhe lojrat, si dhe reklamat dhe teleshopingun. Së paku 40% nga programet e RTM-së të emetuara mes orës 18:00 dhe 22:00 (llogaritur në nivel vjetor) duhet të jenë të prodhuara në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e komuniteteve joshumicë. Ky minimum obligues bie në 30 për qind për programet ditore. Të gjitha kanalet e Radios së Maqedonisë janë të obliguara së paku 49 për qind të programeve ditore të emetuara të jenë në mënyrë burimore të prodhuara në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën e komuniteteve joshumicë, ndërsa 45 për qind nga kompozimet vocalo instrumentale të emetuara duhet të jenë në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e komuniteteve joshumicë.<sup>52</sup>

Kufizimet programore për TVM-në përfshijnë edhe ndalesën e emetimit të: programeve të cilat mund të paraqesin rrezik për rendin kushtetues; programe të cilat ftojnë për agresion armiqësor ose shkaktojnë urrejtje dhe jotolerancë nacionale, etnike, fetare ose gjinore, përmbajtje të cilat mund të pengojë zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve dhe shkeljen e dispozitave për teleshoping, sponzorim dhe emetimin e lojërave të fatit.<sup>53</sup>

Me ligjin e vitit 2005, dispozitat ligjore për reklamim u bënë shumë më restriktive. Në televizion nuk është e lejuar emetimi i reklamave pas orës 17:00. Në radioi, reklamimi mes orës 09:00 dhe 14:00 është i ndaluar, përveç gjatë transmetimeve të garave sportive, dhe ngjarjeve kulturore dhe ngjarjeve të tjera të mëdha, siç është e përcaktuar në ligj.<sup>54</sup>

<sup>50</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 121.

<sup>51</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 122.

<sup>52</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 123-124.

<sup>53</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 69-70.

<sup>54</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 91.

Digjitalizimi i RTM-së është akoma në fazën fillestare. Nuk ekziston buxhet për zhvillim të teknologjive dhe shërbimeve të reja e mediave, më së shumti për shkak të krizës së vazhdueshme financiare. Në kuadër të Strategjisë nacionale për zhvillim të radiodifuzionit, në mars të vitit 2007 u themelua grup specializuar i ekspertëve për digjitalizim, në të cilën morën pjesë profesorë të studimeve elektroteknike dhe ekspertë nga lëmi i elektrokomunikacioneve.<sup>55</sup> Në mars të vitit 2008, Këshilli për Radiodifuzion themeloi një trup nacional këshillëdhënës për digjitalizimin, në të cilën merr pjesë edhe RTM-ja. Trupi deri më tani është takuar vetëm një herë. Mbetet e paqartë cilat janë obligimet dhe funksioni i këtij trupi.

### 3.2 Struktura drejtuese e SRP-së

Struktura drejtuese e RTM-së përbëhet nga Këshilli I RTM-së, Bordi drejtues dhe drejtori gjeneral i RTM-së. Këshilli i RTM-së kujdeset për mbrojtjen e interesit publik në programet e RTM-së dhe bën mbikëqyrjen e punës së shtëpisë. Bordi drejtues kujdeset për menaxhimin e shtëpisë. Drejtorët gjeneral menaxhojnë dhe e përfaqësojnë RTM-në.

Bordi drejtues ka shtatë anëtarë, të zgjedhur në periudhë prej pesë vitesh me drejtë të rizgjedhjes një herë. Anëtarët u zgjedh Këshilli i RTM-së në bazë të konkursit publik paraparak.<sup>56</sup> Paraprakisht, Bordi drejtues kishte 11 anëtarë të cilët emëroheshin nga ana e Kuvendit të RM-së, nga kandidatët e nominuar nga ana e Komisionit për zgjedhje dhe emërimet dhe nga Këshilli i të punësuarve në RTM, trup ky që do të prezantojë të punësuarit në stacion.

Anëtarë të Bordit drejtues nuk mund të jenë:

- Deputetë në Kuvend,
- Anëtarë të qeverisë,
- Persona udhëheqës në organe shtetërore, organe të administratës shtetërore ose të “njësive të vetë administrimit lokal” (qyteti i Shkupi dhe 84 komunitat në vend),
- Drejtor ose anëtarë të këshillave drejtues të ndërmarrjeve publike,
- Persona të cilët punojnë për parti politike,
- Persona të cilët posedojnë pjesë të organizatave radiodifuzive, agjenci gazetareske, kompani reklamuese, kompani për hulumtimin e tregut dhe

<sup>55</sup> Planet për implementimin e radiodifuzionit digjital janë pjesë e Strategjisë për zhvillim të radiodifuzionit, e publikuar në faqen e internetit të Këshillit për radiodifuzion.

<sup>56</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 134

opinionit publik, producent të filmit dhe distributor dhe kompani të telekomunikacionit,

- anëtarë të Këshillit të RTM-së ose të punësuar në RTM.<sup>57</sup>

Detyrat e Këshillit drejtues (bordit drejtues) përfshijë dhe udhëheqjen me pronën e përgjithshme të RTM-së monitorimin e punës së RTM-së dhe realizimin e planit vjetor financiar, miratimin e planit operativë dhe llogarisë vjetore, dhe dorëzimin e raportit vjetor.<sup>58</sup> Këshilli drejtues emëron drejtorët e përgjithshëm dhe zëvendësit e tyre.

Këshilli i RTM-së është i përbërë nga 23 anëtarë, të emëruar për periudhë pesë vjeçare me të drejtë të një riemërimi.<sup>59</sup> Kuvendi i emëron anëtarët nga nominimet e organizatave si vijon:

Pesë nominime jep:

- Komisioni kuvendar për zgjedhje dhe emërimë,

Dy nominime japin:

- Universiteti Shën Qirili dhe Melodi,
- Universiteti shtetërorë i Tetovës,
- Shoqata e gazetarëve në Maqedoni.

Nga një nominim japin:

- Universiteti Shën Kliment Ohridski në Manastiri,
- Universiteti i Evropës juglindore në Tetovë
- Teatri shqiptar,
- Teatri turk,
- Shoqata e njësive të vetë administrimit lokal (ZELS),
- Komiteti olimpik i RM-së,
- Oda ekonomike e RM-së,
- Asociacioni maqedonas për teknologji informative,
- Akademia e muzikës,
- Shoqata e kompozitorëve,

---

<sup>57</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 136.

<sup>58</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 138.

<sup>59</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 127.

- Fakulteti i arteve dramatike,
- Shoqata e organizatave të invalidëve në Maqedoni.

Kriteret për mospërputhshmëri me postin e anëtarit të Këshillit të RTM-së janë pothuajse të njëjta me ato të cilat janë për Bordin drejtues. Gjatë shqyrtimit të kandidatëve, Kuvendi duhet të merr parasysh nevojën e prezantimit adekuat dhe të barabartë të qytetarëve nga të gjitha komunitetet.<sup>60</sup> Në përbërjen e tanishme, dhjetë nga anëtarët e Këshillit janë të përkatësisë etnike shqiptare, turke, vllahve dhe rome.

Këshilli i RTM-së është i obliguar të kujdeset për mbrojtjen e interesit publik në programet e RTM-së, bazuar në parimet e politikës redaktuese të pavarur dhe autonome, ai e miraton politikën programore të shtëpisë dhe propozon dhe kujdeset për implementimin e drejtimeve programore. Në rast të shkeljes së tyre, Këshilli dërgon vërejte më shkrim deri te udhëheqësi dhe kërkon nga menaxhmenti të ndërpret me emetimin e atij programim. Këshilli është përgjegjës edhe për:

Emërimin e anëtarëve të Bordit drejtues; miratimin e Statutit të ndërmarrjes; raportin vjetor dhe atë financiar; akte me të cilat rregullohen standartet etike dhe profesionale në programet e RTM-së Këshilli po ashtu miraton buxhetin vjetor dhe e dorëzon deri te Kuvendi.<sup>61</sup>

Në strukturën e re, Këshilli mundohet të ketë ndikim mbi radiodifuzerin, sidomos lidhur me politikën redaktuese dhe programore. Duke marrë parasysh krizën e thellë financiare në të cilën gjendet RTM-ja dhe grevën 80-ditore e të punësuarve në qershor të vitit 2006, këshilli ballafaqohet me detyra të rënda që nga momenti i emërimit të tij në Maj 2006. Gjashtë muaj më vonë, kryetari i këshillit Goran Koevski dha dorëheqje me arsyetim se grevistët nuk i respektojnë strukturat udhëheqëse. Për anëtarë të ri të Këshilli u emërua Zoran Bojarovski, gazetarë dhe profesor i lëndës së gazetarisë.<sup>62</sup> Por, marrëdhëniet në Këshilli e RTM-së mbeten të tensionuara. Një plan për shpëtimin e RTM-së, i përgatitur nga ana e ekipit të menaxherëve të shtëpisë, nuk u pranua nga ana e Këshillit.<sup>63</sup>

Drejtori i përgjithshëm zgjidhet për një periudhë katër vjeçare me të drejtë të edhe një mandate. Drejtorin e emëron Bordi drejtues i RTM-së, në bazë të konkursit publik. Deri më vitin 2005, drejtori ekzekutiv i RTM-së emërohej nga ana e Kuvendit, me ç'rast fjalën kryesore e kishte koalicioni në pushtet. Sipas ligjit për radiodifuzion të vitit 2005, drejtorët e përfaqësojnë RTM-në në opinion, udhëheqin politikën afariste të shtëpisë, propozojnë program për zhvillim të RTM-së, propozojnë dhe implementojnë

<sup>60</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 128.

<sup>61</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 133.

<sup>62</sup> Verçe Georgievska, "Kryetari I Këshillit të RTM-së dha dorëheqje", Utrinski vesnik, 7 nëntor 2006.

<sup>63</sup> Intervistë me Zoran Bojarovski, kryetar I Këshillit të RTM-së, 20 tetor 2007.

buxhetin vjetor, implementojnë politikën afariste, organizojnë dhe menaxhojnë procesin operativë, operacionalizojnë vendimet e Këshillit të RTM-së dhe Bordit drejtues, emërojnë dhe shkarkojnë anëtarët e ekipeve të menaxherëve.<sup>64</sup>

Më 13 nëntor të vitit 2006, Bordi drejtues emëroi Boris Stavrovin për drejtor të ri të RTM-së. Stavrov është magjistër në lëmin e administratës afariste dhe ligjëron në Kolegjin amerikan në Shkup. Stavrovi erdhi nga posti në Telekomunikacioni i Maqedonisë, operator nacional i telekomunikacionit, në pronësi të telekomit hungarez MATAV. Stavrov ishte edhe anëtar i Bordit të drejtorëve të T-mobajl, kompani në pronësi të Telekomit të Maqedonisë.<sup>65</sup>

Amendamentet e Ligjit të vitit 2007 përsëri e ndryshuan strukturën udhëheqëse të RTM-së. Në vend të drejtorit gjeneral, Ligji parashikoi tim menaxherial të përbërë nga dy drejtorë ekzekutivë dhe zëvendës të tyre, të barabartë në detyrat lidhur me punën e RTM-së. një ndryshim tjetër I rëndësishëm ishte lejimi që shtetasit e huaj të mund të zgjidhen në poste udhëheqëse.<sup>66</sup> Dispozitat e tjera që kanë të bëjnë me organet udhëheqëse të shtëpisë dhe kompetencat e tyre nuk pësuan ndryshime. dispozitat e reja u aplikuan, ashtu që në këtë moment drejtor ekzekutivë janë Boris Stavrov dhe shtetasi sloven Janes Sajovic, i cili ka qenë i angazhuar në projekte për transformimin e radiodifuzionit shtetëror në Mal të Zi dhe Kosovë. Sajovic së pari ka punuar në RTM si konsultat i OSBE-së dhe mori shtetësinë e Maqedonisë një javë para se Gjykata kushtetuese të vendos se shtetas të huaj nuk mund të jenë në pozita udhëheqëse në ndërmarrje publike.

Në janar të vitit 2008, Stavrov dha dorëheqje për shkaqe shëndetësor. Në vend të tij erdhi Maja Mishkovska, paraprakisht gazetare në javoren Puls dhe në gazetën Nova Makedonija. Mishkovska ishte anëtare e këshillit mbikëqyrës të kompanisë kimike dhe farmaceutike OHIS. Në këtë pozitë ishte e nominuar nga ana e Qeverisë.

### 3.3 Financimi i SRP-së

RTM-ja financohet nga taksa radiodifuzive, nga reklamimi, sponzorimi, donacionet, shitja e programit dhe shërbimeve dhe nga buxheti i RM-së.<sup>67</sup> Burimi kryesor i financimit duhet të jetë taksa radiodifuzive, të cilën e paguajnë të gjitha amvisëritë, hotelet dhe motelet, kompanitë dhe pronarët e objekteve afariste, ndërmarrjet hotelierike dhe institucione të tjera publike. Ajo llogaritet në nivel vjetor, si 2.5 për qind të pagës mesatare mujore gjatë katër muajve të kaluar.<sup>68</sup> Një amendament i cili

<sup>64</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 141.

<sup>65</sup> Verçe georgievski, "Menaxher i telekomit vjen në krye të RTM-së", Utirnski vesnik, 14 nëntor 2006.

<sup>66</sup> Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për radiodifuzion (2007) neni 4.

<sup>67</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 116.

<sup>68</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 146-148.

është në procedurë kuvendare, propozon uljen e taksës në një për qind të pagës mesatare mujore, si motivim për qytetarët të paguajnë atë.<sup>69</sup>

Sistemi i tanishëm për llogaritjen e taksës radiodifuzive ishte i paraqitur me Ligjin për Radiodifuzion të viti 1997. Deri më vitin 2006, mesatarja e grumbullimit të taksës ishte mes 60 deri më 70 për qind. Në vitin 2006 niveli i grumbullimit ra në vetëm gjashtë për qind, për shkak të konfuzionit të shkaktuar me ndryshimin e modelit të grumbullimit. Ky nivel u grumbullimit e solli RTM-në para kolapsi dhe solli deri te dorëheqja e drejtorit të atëhershëm ekzekutiv. Të punësuarit nuk merrnin pagat mujore edhe me disa muaj. Në kombinim me politizimin gjithmonë e më të madh në shtëpi, gjendja i detyroi të punësuarit të shpallin grevë. Për të zvogëluar tensionet, Qeveria siguroi injeksion financiar me transferimin e të hollave nga llogaria e Ndërmarrjes publike për shërbime të aeroportit. AMEPM-i gjykoj këtë akt, si dëshmi se Qeveria sponsoron RTM-në pa u marrë seriozisht me RTM-në.<sup>70</sup>

Buxhetet e TVM1 dhe TVM2, si dhe buxhetet e radio kanaleve MR1, MR2 dhe MR3, mbushen nga taksa radiodifuzive. Harxhimet për prodhimin e programit të kanalit të Kuvendit i mbulon kuvendi.<sup>71</sup>

Të ardhurat nga taksa radiodifuzive, shpërndahen në këtë mënyrë:

- 72% për mbulimin e harxhimeve të produksionit dhe emetimit të RTM-së;
- 4.54% për zhvillim teknik dhe teknologjik të RTM-;
- 16% për mbulimin e harxhimeve të mirëmbajtjes dhe përdorimit të rrjetit publik radiodifuziv të MRD-së;
- 3,5% për zhvillimin e rrjetit publik radiodifuziv të MRD-së;
- 4% për Këshillin për Radiodifuzion, për rregullimin dhe zhvillimin e radiodifuzionit në Maqedoni.<sup>72</sup>

Ligji për radiodifuzion i vitit 2005 nuk solli ndryshime të rëndësishme lidhur me dispozitat e reklamimit në RTM. Kufizimi nga 7 për qind ose 4 minuta e 12 sekonda për çdo orë emetimi për TVM-në mbetën. Kjo dispozitë ka të bëjë vetëm më programet e filmit, sportive dhe zbavitëse. TVM-ja nuk guxon të emetojë reklama në periudhën mes 17:00 dhe 21:00.<sup>73</sup>

Më brenguese është bilanci i të ardhurave dhe harxhimeve të RTM-së, para së gjithash për shkak të kolapsit të financimit nëpërmjet taksës radiodifuzive. Në gjashtë muajt e

<sup>69</sup> Propozim i Ligjit për Radiodifuzion, neni. 134.

<sup>70</sup> Marjan Blazhevski, "AMEPM proteston kundër RTMV-së", *Dnevnik*, 9 maj 2007.

<sup>71</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 119.

<sup>72</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 149.

<sup>73</sup> Ligji për Radiodifuzion neni, 51 и Buletini e Këshillit të RM-së, pjesa 1 1998.

dytë të vitit 2006, grumbullimi ra në vetëm 6 për qind. Në këtë periudhë grumbullimi I transferua nga Elektrodistribucioni (EVN Maqedoni) në RTM.<sup>74</sup>

Qeveria u obligua të sigurojë një shumë në nivel të 80 për qind e të ardhurave të përgjithshme nga taksa radiodifuzive në periudhën e gjashtë muajve të fundit të vitit 2006 nga buxheti, kështu që RTM-ja mundej të vazhdojë me strategjinë e reformimit para se të fillojë vet të grumbullojë taksën radiodifuzive.<sup>75</sup> Por pagesa e kështit të parë u anulua për më shumë se një vjet.<sup>76</sup>

Situata u bë edhe më e vështirë, pasi që nga janari i vitit 2007 taksa radiodifuze nuk mblihdje aspak, për shkak se RTM-ja pohonte se nuk posedon listë të amvisërive të cilat duhet të bëjnë pagesën e taksës. (vetëm një vit më herët, pothuajse të gjitha amvisëritë në shtet morën faturën për pagesën e taksës radiodifuzive).<sup>77</sup>

Kështu që, grumbullimi ra në mënyrë dramatike në vitin 2007 në jo më shumë se 0.5 për qind të amvisërive. Sipas planit të punës së RTM-së për vitin 2007, shtëpia planifikonte të mbulojë vetëm 9 për qind të buxhetit të saj nga taksa, edhe pse deri më atë moment, taksa konsiderohej se burim kryesor i të ardhurave të RTM-së. Shuma e saktë e buxhetit vjetor të RTM-së nuk dihet. Sipas situatës së tanishme, RTM-ja vuan nga një mungesë e madhe e mjeteve financiare, që nuk mund ti mbulojë as harxhimet themelore.

**Tabela 4. Buxheti I RTM-së për 2005–2006**

Llojet e të ardhurave	Pjesëmarrje në të ardhurat e përgjithshme (në për qindje)	
	2005	2006
Taksa radodifuzive	86.9	16.5
Të ardhurat nga reklama	6.8	56.8
Të ardhurat nga sponsorimi	0.1	0.5
Të ardhurat nga donacionet	0.0	2.2
Të ardhurat e tjera	6.2	24.0
Gjithsej	100.0	100.0

**Burim:** Këshilli për Radiodifuzion<sup>78</sup>

<sup>74</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 147.

<sup>75</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 178.

<sup>76</sup> Verçe Georgievska, “Krizë në RTM do të sanohet me paret e ndërmarrjeve publike”, *Utrinski vesnik*, 3 shkurt 2007.

<sup>77</sup> Intervistë me ekspertë të mediave dhe aktivistë, Shkup, 7-10 prill 2008.

<sup>78</sup> Këshilli për radiodifuzion, Raporti vjetor 2006 dhe Raporti vjetor 2007.



Problemi më i madh lidhur me financimin e RTM-së është jogatishmëria e menaxhmentit të tentojë të grumbullojë taksën në një mënyrë më efektive, për shkak se është shumë më lehtë të pritet që të merren donacione nga Qeveria. Ky pajtim me situatën katastrofale është në mënyrë sistematike i incizuar nga ana e politikanëve të cilët dëshirojnë të mbajnë RTM-në në një varësi financiare nga shteti. Politikanët tjerë, e akuzojnë RTM-në për mospjekësin e grumbullimit të taksës.

### 3.4 Standartet redaktoriale

Ligji për radiodifuzion i vitit 2005 i obligoi radiodifuzerët, si shoqatat komerciale ashtu dhe servisin publik, të bazojnë punën e tyre mbi parimet e “paraqitjes objektive dhe joanëshmërisë të ngjarjeve me një tretman të njëjtë të mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme, duke mundësuar liri në krijimin e opinionit publik për ngjarje dhe çështje të veçanta”, si dhe për “autonominë, pavarësinë dhe përgjegjësinë e radiodifuzerëve, redaktorëve, gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të inkuadruar në krijimin e programeve dhe politikave redaktuese”.<sup>79</sup> MTR-ja ka inkuadruar të njëjtat parime në Deklaracionin e saj për principet profesionale dhe etike, në kodeksin vetë-rregullator të paraqitur vitin 2003. Në Deklaracionin thuhet se “informatat të prezantuara nga radiodifuzeri nuk guxojnë të jenë të njëanshëm, përderisa faktet dhe qëndrimet e prezantuara në programet duhet të jenë të balancuara dhe etike” Deklaracioni po ashtu thotë se “informacionet dhe përmbajtjet tjera duhet të jenë të cituara në mënyrë të drejtë dhe precize”.<sup>80</sup>

Përgjegjësia për respektimin e këtyre standardeve është mbi Këshillin e RTM-së. Sipas Ligjit për Radiodifuzion, Këshilli “kujdeset për realizimin e interesit publik në programet e RTM-së në bazë të parimeve të pavarësisë redaktoriale”.<sup>81</sup> Kjo dispozitë është e inkuadruar edhe në Statutin e RTM-së.<sup>82</sup>

Por, implementimi i këtyre obligimeve ndonjëherë është i përcjellë me mangësi. Për shembull, ekspertët e mediave dhe monitoruesit konsiderojnë se filmi dokumentar “Jeta ime për Maqedoninë” ka ofenduar kryetarin e shtetit, duke e emëruar kryetarin Branko Crvenkovski “komunist i ricikluar”, i cili nuk ka pasur sukses si kryeministër dhe është bërë kryetar duke dhënë premtime të cilat asnjëherë nuk i ka plotësuar. Filmu dokumentar flet për ish ministrin e punëve të brendshme Bube Boshkovski, i cili është duke u gjykuar nga ana e Tribunalin Ndërkombëtarë për ish Jugosllavinë në Hagë, ku është i akuzuar për vepra të bëra gjatë konfliktit ndëretnik në Maqedonia në vitin

<sup>79</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 68.

<sup>80</sup> RTM, “Deklaracioni për principe profesionale dhe etike në programet”, 2003, Shkup, dokument intern I RTM-së, gjendet në arshivën e RTM-së.

<sup>81</sup> Ligji për Radiodifuzion neni. 133.

<sup>82</sup> Statuti i ndërmarrjes publike Radio-televizioni I Maqedonisë, neni 32. gjendet në internet faqen <http://www.mkrtv.org.mk>.

2001. Në një film tjetër dokumentarë të dedikuar një grupi etnik të quajtur mijakë, shqiptarët karakterizohen se kriminel.<sup>83</sup>

Në të dy rastet RTM-ja reagoi nën presionin e ekspertëve të mediave, OJQ-ve dhe gazetarëve. Në rastin e parë Këshilli i RTM-së e ftoi në përgjegjësi redaktorin përgjegjës të TVM1. Në rastin e dytë, këshilli i RTM-së publikisht iu kërkoi falje shqiptarëve, ndërsa gazetari i cili prodhoi dokumentarin, ishte para humbjes së vendit të punës.

## 4. RADIODIFUZIONI KOMERCIAL

### 4.1 Rregulativa dhe menaxhimi

Stacionet private radio dhe televizione janë të organizuara në tre nivele: nacionale, rajonale dhe lokale. Pjesa më e madhe e të ardhurave shkojnë te radiodifuzerët nacional. Nga ana tjetër, nuk janë vënë re ndryshime më të mëdha në strukturën e tyre dhe në programet. Kompania radiodifuzive private mund të jetë në pronësi të një personi juridik apo fizik. Kryerja e veprimtarisë radiodifuzive iu është ndaluar partive politike, institucioneve të shtetit dhe trupave administrative, ndërmarrjeve publike, njësisve të vetë administrimit lokal, bartësve të funksioneve dhe familjeve të tyre.

Radiodifuzerët janë të obliguar që logoja e tyre të jetë në mënyrë konstante e theksuar gjatë gjithë kohës së emetimit të programit. Radiostacionet duhet të publikojnë emrin e tyre jo më pak se një herë në çdo orë emetimi. Duhet të emetojnë programe në gjuhën maqedonase përveç programeve të dedikuara komuniteteve joshumicë. Programet në gjuhët e huaja duhet të përkthehen në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e komunitetit joshumicë.

Ligji për radiodifuzion i obligon të gjithë radiodifuzerët të kane të punësuar redaktorë përgjegjës për programin, përbajtjen dhe saktësinë e të gjitha informacioneve të emetuara në programet. Emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës publikon së paku një herë në ditë, gjatë kohës së emetimit të programit. Këto obligime janë për të gjithë radiodifuzerët.<sup>84</sup>

### 4.2 Pronësia dhe pronësia e kryqëzuar

Ligji për radiodifuzion i vitit 2005 liberalizoi rregullat për pronësinë e mediave, si për subjektet vendore ashtu edhe për ato të huajat. Radiodifuzeri i cili emeton program në nivel nacional mund të posedon pjesë në edhe një radiodifuzer tjetër, por jo më tepër se 50 për qind. Ai mund të ketë në pronësi, bashkëpronar, vetëm një radiodifuzer rajonal

<sup>83</sup> Jeta ime Maqedonia u emetua më 16 prill 2007, ndërsa Mjakët më 5 qershor 2007, të dyja në TVM1.

<sup>84</sup> Ligji për radiodifuzion neni nr. 141.

dhe maksimum dy radiodifuzer lokal. Radiodifuzerët rajonal mund të kenë pjesë të pronësisë edhe në një radiodifuzer rajonal dhe maksimum në dy lokal, me kusht që rajonet në të cilat funksionojnë mos të kenë kufi të përbashkët. Ligji për radiodifuzion nga viti 2005 nuk solli ndryshime në dispozitat për pronësinë e radiodifuzerëve lokal. Si dhe më parë, një radiodifuzer lokal mund të ketë pako shumicë në pronësinë e jo më tepër se dy radiodifuzerëve lokal.<sup>85</sup> Nga ana tjetër, radiodifuzerëve lokal ju lejua të formojnë rrjete, për emetim të përbashkët për disa orë në ditë.

Që nga 2005 e këndej, subjekteve të huaja ju lejua të kane në pronësi organizata radiodifuzive me të njëjtat kushte si personat fizik dhe juridik nga Maqedonia.<sup>86</sup> Deri më vitin 2005, subjektet e huaja mundeshin të paraqiten si bashkëpronar të kompanive radiodifuzive dhe të kenë jo me tepër se 25 për qind të kapitalit. Në këtë moment asnjë kompani e huaj nuk punon në sektorin radiodifuziv të Maqedonisë. Investimi i vetëm i huaj është tek operatorët televiziv kabllore. Në përgjithësi, investimet e huaja shumë ngadalë hynë në Republikën e Maqedonisë për shkaqë të shumta ekonomike, politike dhe juridike. Investimet e huaja shumë ngadalë hynë sidomos në tregun e mediave, për shkak të mungesës së të dhënave të sakta dhe për shkak të sistemit joadekuat të matjes së shikueshmërisë. Kompanitë e hulumtimeve nuk janë të gatshme që të fillojnë me përdorimin e pople-metër si mjet për matje të shikueshmërisë në një numër më të madh të shikuesve, për shkak të harxhimeve të mëdha dhe jorentabilitetin në një treg aq të vogël. Një sistem paralel i vendosur nga ana e rregullatorit do të mund të ndihmonte të merren të dhëna më precize të cilat do të sillnin një konkurrencë më të madhe në tregun e reklamimit dhe do të tërhiqnin radiodifuzer të huaj.

Në pjesën për mbrojtjen e pluralizmit, llojllojshmërisë dhe transparencës, Ligji për radiodifuzion i vitit 2005 thotë se pronësia e kryqëzuar ndodhë kur “themeluesit” e një stacioni radio apo televizivë:

- në pronësi kanë më tepër kompani radiodifuzive se sa është e lejuar me ligj;
- na pronësi kanë kompani botuese e cila boton gazetë ditore I cili distribuohet në rajonin gjeografikë i cili mbulohet me sinjalin radio apo televiziv të cilin ato mundohen ta blejnë;
- kanë në pronësi agjenci të lajmeve;
- kanë në pronësi kompani të reklamimeve, kompani për hulumtimin e tregut dhe opinionit publik, distributor radiodifuziv, shtëpi produktioni për filma dhe kompani telekomunikacioni.

<sup>85</sup> Ligji për radiodifuzion nenet nr. 82-84.

<sup>86</sup> Ligji për radiodifuzion neni nr. 14.

- Janë në marrëdhënie familjare me personat e tillë.<sup>87</sup>

Mbikëqyrjen mbi koncentrimin jolegal të mediave e bën Këshilli për Radiodifuzion, i cili ka për obligim t'iu jep pronarëve një periudhë prej tre muajve që të adaptojnë punën e tyre me ligjin. Nëse radiodifuzeri nuk ndërmerr hapat e duhura, Këshilli për radiodifuzion duhet të kryen p[rocedurën e marrjes së licencës.<sup>88</sup>

Mirëpo, zbatimi i procedurës nuk është i lehtë. Për shembull, edhe pse ligji nuk lejon pronësinë e TV stacionit dhe mediumit të shtypur, Këshilli për Radiodifuzion nuk reagoi më rastet e shkeljes së dispozitës së tillë. Formalisht, kompanitë janë të regjistruara me emra të ndryshëm dhe nuk ekzistojnë mekanizma për zbulimin e pronarit të vërtet dhe të dëshmohet koncentrimi i mediave. Shembull për këtë është pronari i TV A1, i cili në të njëjtën kohë është pronar i gazetave ditore Shpic dhe Vreme dhe javores Nedelno Vreme (e cili në ndërkohë u mbyll). Qeveria duhet të sigurojë zbatimin e plotë të ligjit, ose ta plotëson dhe të lejojë liberalizmin e plotë të tregut.<sup>89</sup>

Është problem tjetër që politikanët me ndikim, duke përfshirë këtu edhe liderë të partive politike, janë pronar të vërtet të mediave elektronike, ndërsa si pronar formal të paraqitur në regjistrin qendror janë persona të afërt me këto politikanë. Komisioni për mbrojtjen e Konkurrencës është e autorizuar të kryej hetime për procedurat ligjore, në bazë të kërkesës së qytetarëve. Praktikisht ky institucion ka bërë shumë pak.

Ligji për radiodifuzion obligon radiodifuzerët të informojnë Këshillin për radiodifuzion për të gjitha ndryshimet në strukturën pronësore. Radiodifuzerët janë të obliguar të publikojnë raport për aktivitetet e tyre një herë në vjet, duke përfshirë edhe ndryshimet në strukturën pronësore, ndryshimet statutare, ndryshimet në organet drejtuese dhe burimet e financimit. Rregullatori reagoi në dukuritë e tilla. Këshilli dënoi stacionin televiziv Skaj Net, për shkak të ndryshimit të strukturës pronësore pa informuar rregullatorin, dhe ndërmori masa, duke i propozuar qeverisë të tërheq licencën e Skaj Net-it. Në fund Skaj Net-it pati sukses të mos humb licencën.

<sup>87</sup> Termini “marrëdhënie familjare” është i definuar në këtë mënyrë (prindër, fëmijë, vëllezër dhe motra); çifte të apo jo të martuara; anëtarë të familjes së ngushtë të bashkëshortit; aksionar ose bartës së të drejtave të tjera të cilat iu mundësojnë të marrin pjesë në udhëheqjen me radiodifuzerin, me së paku 20 për qind të votës vendimmarrëse; persona të cilët kanë një pronësi të plotë në dy radiodifuzerë ose të drejta të tjera të cilat iu mundësojnë kontrollin mbi vendimmarrjen në to; persona të cilët, në bazë të kontratës së marketingut ose ndonjë lloj tjetër të marrëdhënieve afariste, gjenerojnë më tepër se 30 për qind e të ardhurave vjetore të radiodifuzerit nga reklamat, teleshoppingu dhe sponsorimi; anëtarët e bordit drejtues ose këshillit mbikëqyrës të radiodifuzerit; dhe persona të cilat janë në lidhje familjare me anëtarët e bordit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës të organizatës.

<sup>88</sup> Ligji për radiodifuzion neni nr. 15.

<sup>89</sup> Eroll Rizaov, “Fabrika gazetare u bë concern”, Utrinski vesnik, 7 prill 2007.

Kufizimet të cilat kanë të bëjnë me koncentrimin e pronësisë janë të lidhura me rastet si vijojnë:

- Subjekti radiodifuziv i cili është krijuar me bashkimin ka fituar pozitë dominante në tregun reklamues, d.m.th. pjesa e tij e përgjithshme në tregun reklamues, në radio dhe TV tejkalon 30 për qind;<sup>90</sup>
- Subjekti radiodifuziv i cili është krijuar me bashkimin ka fituar pozitë dominante në kuptimin e krijimit të opinionit publik d.m.th. pjesa e tij në shikueshmërinë e përgjithshme tejkalon 40 për qind;<sup>91</sup>
- Bashkimi i radiodifuzerëve lokal dhe rajonal krijon situatën në të cilën kompania e re e formuar radiodifuzive mbulon më tepër se 50 për qind nga popullata e përgjithshme e vendit.<sup>92</sup> Akoma nuk janë regjistruar raste të tilla.

### 4.3 Tregu reklamues

Struktura e industrisë së mediave nuk është ndryshuar për një kohë të gjatë. Aktorët kryesor janë TV stacionet komerciale nacionale, përderisa një numër i madh i radio dhe TV stacioneve mundohen të mbijetojnë. Gjendja është edhe më e rëndë në vendet e vogla me një ekonomi të varfër.

Pjesën më të madhe të “tortës” së reklamave e ndajnë A1, Kanal 5 dhe Sitel, ndërsa TVM ka një pjesë të vogël nga të ardhurat. Në vitin 2006 në TV reklamat janë harxhuar bruto 7.4 miliardë qenarë (121.1 milion euro), 79, 8 për qind nga të gjitha mjetet e harxhuara për reklamim në vend.<sup>93</sup>

<sup>90</sup> Tregu i reklamave i përfshinë të gjitha të ardhurat nga reklamimi televiziv në vitin para bashkimit.

<sup>91</sup> Shikueshmëria e përgjithshme llogaritet na bazë të treguesve nga matjet e shikueshmërisë gjatë një viti kalendarik para bashkimit.

<sup>92</sup> Mbulimi me sinjal llogaritet në bazë të treguesve nga regjistrimi I fundit I popullatës Republikën e Maqedonisë (Ligji për radiodifuzion neni nr. 17).

<sup>93</sup> IP International Marketing Committee, *Television 2007, International Key Facts*, October 2007, p. 272.

**Tabela 5. Pjesëmarrja në të ardhurat nga reklamimi të televizioneve në bruto për vitin 2006**

Kanali	Pjesë nga tregu (në për qindje)
A1	51.0
Kanal 5	21.6
Sitel	17.1
Telma	7.7
Alsat-M	0.9
Era-Shkup	0.8
TVM1	0.8
TVM2	0.1

Burim: Media & Advertising<sup>94</sup>

Numri më i madh i shkeljeve të dispozitave janë të lidhura me reklamimin. Sipas të dhënave të fundit të Këshillit për radiodifuzion, stacionet të cilat grumbullojnë pjesën më të madhe e të ardhurave nga reklamat, më së shumti bëjnë shkeljen e ligjit me emetimin e reklamave në mes të lajmeve, programe për fëmijë ose me emetimin e reklamave të fshehura ose tejkalimin e kufizimeve.<sup>95</sup>

#### 4.4 Standartet editoriale dhe pavarësia

Ligji për radiodifuzion rregullon çështjen e pavarësinë editoriale nga ndikimi i qeverisë dhe biznesit. Çdo radiodifuzer duhet të ketë redaktorin përgjegjës, përgjegjës për përmbajtjen dhe vërtetësinë e informative të emetuara në program.<sup>96</sup> Njëkohësisht, gazetarëve të të gjithë mediave iu është garantuar mbrojtja e burimit të informacionit.<sup>97</sup>

Nga ana tjetër, në realitet neutraliteti politika dhe paanshmëria në raportim rëndë mund të rruhet në situatë kur mediat me ndikim të madh janë pronë e liderëve të partive politike dhe të personave të tjerë me lidhje politike. Sitel është në pronësi të prodhuesit të silikateve Sileks, i cili është nën kontroll të Lubisav Ivanov, deputet dhe

<sup>94</sup> Media & Advertising, "Analytica", Shkup, 2007.

<sup>95</sup> Baza e të dhënave e departamentit programor të Këshillit për radiodifuzion, 2007.

<sup>96</sup> Ligji për radiodifuzion neni. 84.

<sup>97</sup> Ligji për radiodifuzion neni. 162.

kyetar i Partisë Socialiste. Djali i tij është drejtor i televizionit.<sup>98</sup> Pronar i Kanal 5 është Emil Stojmenov, i biri i Boris Stojmenovit, ish ministri i financave të Maqedonisë.<sup>99</sup>

Informimi në favor të një parti të caktuar politik ose rreth politik, është i dukshëm gjatë fushatave zgjedhore. I tillë ishte rasti në vitin 2006, kur në bazë të monitorimit të zbatuar, Këshilli për radiodifuzion shqiptoi 90 sanksione për shkeljen e dispozitave për mundësi të njëjta të prezantimit në medium gjatë kohës së zgjedhjeve parlamentare. Shkeljet kishin të bëjnë me mbulim jo të balancuar të zgjedhjeve dhe emetimin e reklamave të paguara politike. Radiodifuzerët komercial më së shumti kohë iu dedikonin partive të caktuara politike.<sup>100</sup>

#### 4.5 Radiodifuzioni rajonal dhe lokal

Ligji për radiodifuzion i vitit 2005 prezantoi për herë të parë konceptin e radiodifuzerëve rajonal, duke definuar si “aktivitet radiodifuziv të cilin e kryen radiodifuzer i cili siguron mbulesë, në kuptimin e dëgjuesve dhe shikuesve, në territor të disa komunave që bëjnë një rajon natyror gjeografik apo demografike me popullatë mes 150.000 deri më 400.000 banorë. Qyteti i Shkupit dhe rrethina e tij konsiderohen se rajon në vete”.<sup>101</sup>

Në bazë të rregullativës së re, nga stacionet ekzistuese që morën licenca radiodifuzive, 27 janë stacione në Shkup (11 TV dhe 16 Radio), morën licenca rajonale. Numri më i madh janë kanale të formatit të përgjithshëm, të fokusuar në zbavitje. Radio stacionet zakonisht plotësojnë programin e tyre me muzikë dhe emisione kontaktive. Ligji i definon televizionet lokale si radiodifuzerë të cilët mbulojnë një vend të vetëm të banuar me rrethinën, me një popullatë të përgjithshme prej 150.000 banorë.<sup>102</sup>

Nuk ka ndryshime të mëdha në numrin e stacioneve lokale dhe në programet e tyre. Përmbajtjet zbavitëse dominojnë edhe në programet e tyre. Stacionet lokale janë duke u munduar të mbijetojnë si rezultat i burimeve të dobëta financiare dhe ekonomisë të pazhvilluar lokale.

Edhe pse Ligji për radiodifuzion i vitit 2005 prezantoi edhe konceptin e radiodifuzionit joprofitabil, ky sektor praktikisht nuk ekziston. Deri më tani është dhënë vetëm një licencë e tillë, një radio stacioni studentor. Për zhvillimin e këtij sektori, këshilli për

<sup>98</sup> Për më tepër informata për strukturën pronësore të TV stacioneve në Maqedoni shiko Pronësia e mediave dhe ndikimi i saj mbi pavarësinë e mediave dhe pluralizmit *MIM*, Shkup, 2004, f. 63–68.

<sup>99</sup> Këshilli për radiodifuzion, Raporti vjetor 2007.

<sup>100</sup> Raport I Këshillit për radiodifuzion për monitorimin e fushatës zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare 2006.

<sup>101</sup> Ligji për radiodifuzion neni. 4.

<sup>102</sup> Ligji për radiodifuzion neni. 4.

radiodifuzion duhet të miratojë akte nënligjore me dispozita për nxitjen e radiodifuzerëve joprofitablë. Rregullatorët po ashtu duhet të fillojnë bisedimet me grupet nga shoqëria civile për të vlerësuar potencialin e sektorit joprofitabil.

## 5. PROGRAMET

### 5.1 Oferta programore

Programet e TVM-së nuk dallohen shumë për nga kualiteti nga programet e stacioneve private, përkundër dallimet janë në programet gjenerike, për shkak se TVM-ja emeton shumë më pak zbavitje dhe shumë më shumë programe edukative nga konkurrenca komerciale.

**Tabela 6. Emisionet të stacioneve më të mëdha televizive në vitin 2006 (në për qindje)<sup>103</sup>**

Kanal	Zhanri		
	Zbavitës	Informativë –lajme	Programe edukative
TVM1	47.4	27.1	25.5
A1	72.6	22.7	3.3
Sitel	74.0	22.3	3.6

Në televizionet lokale vitin e kaluar në skemën programore dominonin seriale dramatike, kryesisht seriale të gjata nga SHBA-të dhe Amerika Latine, ndërsa pjesa tjetër e programit të emetuar ishte i fokusuar në zbavitje dhe muzikë.<sup>104</sup>

Publiku edhe më tutje parapëlqen formate të televizioneve “reale”, programin e sportit dhe seriale dramatike. Programi më i shikuar në vend në vitin 2006 ishte kuisi “Kush do të jetë milioner?” Në televizionin A1, i cili arriti rejting mesatar të shikueshmërisë prej 29.3 për qind. Lajmet qendrore të televizionit A1 po ashtu kanë rejting të shikueshmërisë të lartë 27.5 për qind. Pas tyre janë kupa botërore në futboll (23.5 për qind), të cilën e transmetonte TVM dhe programi i animuar “Ednookoi” në A1 me 22.1 për qind.<sup>105</sup>

<sup>103</sup> Baza e të dhënave e Këshillit për radiodifuzion monitorimi i radio stacioneve dhe televizioneve publike dhe private, dokument intern, shkurt 2007.

<sup>104</sup> Monitorimi I programeve të radiove dhe televizioneve, Këshilli për radiodifuzion, dokument intern, 2007.

<sup>105</sup> SMMRI, “Top 20 programmes in 2006”, Shkup.



Të gjithë stacionet televizive nacionale janë të formatit të përgjithshëm. Të gjithë i kushtojnë vëmendje të madhe programit filmor. Nga produktioni vetanak, lajmet kanë vendin qendror. Lajmet emetohen disa herë në ditë, ndërsa lajmet qendrore zgjasin edhe nga një orë. Lajmet janë zhanri në të cilin mediat kanë një garë të drejtpërdrejtë, si në aspekt të përmbajtjes ashtu edhe për nga numri I gazetarëve të angazhuar, gjë që është e kuptueshme, për shkak se lajmet janë një nga zhanret më të parapëlqyera të shikuesve në Maqedoni. Lajmet janë programet më të shikuara në televizionet private. Për shembull, 51 për qind të publikut nacional i shikon lajmet e A1 çdo ditë, 33 për qind të Kanal 5 dhe 26 për qind të TV Sitel. Lajmet e TVM1 kanë shikueshmëri prej 18 për qind, ndërsa të TVM2 11 për qind.<sup>106</sup>

Për fat të keq, programet edhe më tutje janë mbushura më shkelje e të drejtave autoriale. Programet pirate në rrjetet kablore, për shembull, shkaktojnë dëme serioze buxhetit shtetëror dhe në mënyrë indirekte edhe për tregun e reklamimit. Grupe të shoqërisë civile siç është QZHM-ja, tentojnë të institucionalizojnë bashkëpunimin me institucione të ndryshme shtetërore në luftën kundër piraterisë. Lufta e tyre përfshinë disa hapa- implementimin e legjislacionit për parandalimin e piraterisë, edukimin e aktorëve të inkuadruar në luftën kundër piraterisë, koordinimin e punës së gjykatave dhe krijimin e data bazës për bartësit e të drejtave autoriale.

## 5.2 Dispozitat e përgjithshme dhe kuotat

Ligji për radiodifuzion është në përputhshmëri me të gjitha standertet e mediave dhe audio vizuale dhe legjislacionet evropiane (*acquis communautaire*). Standertet programore për veprat evropiane, veprat në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e tjera lokale janë të përpunuara në detaje të imta. Radiodifuzerët komercial nacional janë të obliguar të emetojnë vepra audio vizuale evropiane në një sasi prej 51 për qind të programeve të përgjithshme të emetuara në një vit. RTM-ja duhet të mbush së paku 60 për qind të programit të saj me vepra të tilla.

Radiodifuzerët privat janë të obliguar të ndajnë së paku 30 për qind të kohës së përgjithshme gjatë një dite për programet e krijuara në gjuhën Maqedoni ose në gjuhën e komuniteteve të tjera, ndërsa obligimi i RTM-së është 40 për qind. RTM-ja respekton dhe plotëson këtë obligim, madje e tejkalon. Programet e Radios së Maqedonisë në të gjitha tre radio serviset janë plotësisht produksion origjinal. Në sektorin privat, radio stacionet nacionale dhe rajonale dhe stacionet televizive i plotësojnë këto kuota. Nga ana tjetër, numri më i madh i stacioneve private lokale nuk kanë sukses në plotësimin e kuotave, për shkak se nuk mundën të blejnë programe të cilat do t'u mundësonin plotësimin e minimumit të kërkuar.

Të gjithë radiodifuzerët janë të obliguar t'iu kushtojnë së paku 30 për qind të kohës së emetuar kompozimeve vokale instrumentale në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e

<sup>106</sup> SMMRI, “nevojat programore të publikut televiziv në RM”, qershor 2007.

komuniteteve etnike. MTR-ja respekton këtë obligim, posaçërisht në serviset e radios. Televizionet dhe radio stacionet lokale private në një masë të madhe plotësojnë këtë kuotë.<sup>107</sup>

Në kategorinë e obligimeve speciale për programet e radiodifuzerëve. Këshilli për radiodifuzion ka definuar, se vendime dhe rregullore, të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me ngjarjet me rëndësi të madhe, ngjarje me të drejtë ekskluzive për emetim, rruajtjen e identitetit kulturorë, promovimin e veprave evropiane audio vizuale, mbrojtjen e rinisë, obligimet lidhur me reklamimin dhe sponsorimin.

Për herë të parë, radiodifuzerët kanë definuar programin e tyre sipas formateve të ofruara nga ana e Këshillit për radiodifuzion më 30 nëntor 2006. Te televizionet në të gjitha nivelet të emetimit dominojnë programet e “formatit të përgjithshëm me karakter zbavitës”. Radiostacionet nacionale dhe rajonale, kryesisht janë të përqendruara në formatin foljor/muzikor. Radio stacionet lokale janë po ashtu më tepër në formatin foljor/muzikor.<sup>108</sup> Oferta programore është e vobektë dhe e pandryshuar, sidomos te radiodifuzerët lokal.

### 5.3 Obligimet e SRP-së

TVM-ja ka obligime plotësuese programore. Këtu është i përfshirë edhe obligimi i mbulimit rajonal dhe lokal. Çdo ditë TVM1 emeton programe me mbulim të tillë, derisa radioja maqedonase servisi i parë, emeton dy programe të tilla. MR-ja po ashtu është e obliguar që të emetojë programe speciale për vendet fqinje dhe Evropë, si dhe programe për qytetarët e Maqedonisë që jetojnë jashtë vendit. Po ashtu, RTM-ja duhet të sigurojë servis programor i cili do të mbulojë vetëm aktivitetet e Kuvendit të RM-së. Kanali kuvendar ka një status të posaçëm ligjor. Është i organizuar nga ana e Kuvendit, ndërsa monitorimin e punës së tij është obligim i një komisioni të posaçëm të kuvendit.

RTM-ja po ashtu ka obligime të posaçme lidhur me gjuhën. Ajo është e obliguar të ofrojë programe jo vetëm në gjuhën maqedonase, por edhe në gjuhët e bashkësive etnike të cilat jetojnë në vend. Ky princip është plotësisht i respektuar, ndërsa kohëzgjatja e programit varet nga madhësia e bashkësisë etnike. Programet për bashkësitë etnike emetohen në TVM2 dhe MR3, më i njohur si “Kanali i bashkësive etnike”. Programet emetohen në gjuhën shqipe, turke, serbe, rome, vllëve dhe boshnjake.

<sup>107</sup> Këshilli për radiodifuzion, “Monitorimi i programeve të radiove dhe televizioneve”, 2007.

<sup>108</sup> Këshilli për radiodifuzion, “Analizë e programeve të ofruara për harmonizimin e të drejtave të koncesioneve me licenca radiodifuzive”, 2007.

## 6. PËRFUNDIME

Radiodifuzioni në Maqedoni është duke kaluar nëpër një periudhë të ndryshme dhe zhvillimit. Miratimi i Ligjit për radiodifuzion të vitit 2005 shënoi fillimin e vërtet të procesit të rekonstruimit rregullator dhe organizativ.

Për herë të parë, përkrah sektorit publik dhe komercial, legjislacioni i ri definon edhe sektorin e tretë, sektorin joprofitabil radiodifuziv. Licenca e parë për radiodifuzer joprofitabil u dha në korrik të vitit 2007, radios studentore, e cila funksionon në kuadër të Universitetit Shën Qirili dhe Metodi. Ekspertët besojnë se ky sektor mund të luaj një rol të rëndësishëm në avancimin e nevojave dhe interesave të grupeve specifike, me kusht që rregullatori të sigurojë një mbështetje permanente. Këshilli për radiodifuzion është i përgatitur të ndaj më tepër licenca për radiodifuzer joprofitabil, por deri më tani nuk ka pranuar kërkesa me shkrim dhe sektori në këtë moment është inekzistues, duke u ballafaquar me definimin e standardeve, kritereve të punës dhe financimin.

RTM-ja po kalon nëpër ndryshime të shumta strukturore dhe organizative. Numri i serviseve është i zvogëluar në dy televizion dhe katër radio. Në pajtueshmëri me ligjin për radiodifuzion, Këshilli për radiodifuzion vendosi që 29 radio stacionet lokale të transformohen në radiodifuzer komercial. Detyrën për sigurimin e mbulimit me lajme rajonale dhe lokale e mori TVM-ja.

Radiodifuzioni komercial u liberalizua, por ende nuk ka investime të huaja. Edhe pse jo tërësisht i rregulluar, tregu u televizionit kabllor është një përjashtim – kompania e parë e huaj hyri me investim dhe planifikon zgjerimin e mëtutjeshëm.

Ligji për radiodifuzion i vitit 2005 ofron një bazë të mirë për zhvillimin e radiodifuzionit në Maqedoni. Implementimi, nga ana tjetër, është i ngadalshëm dhe i fragmentuar. Shkeljet në shumicën e rasteve kalojnë pa dënime, ndërsa ndikimi i politikës dhe biznesit, ende është prezent.

Situata është më kritike në servisën radiodifuziv publik. Të gjitha reformat e deritanishme, kryesisht në nivel institucional, u treguan sit ë padobishme, RTM-ja është e shkatërruar nga aspekti financiar, gjë që ka ndikim serioz mbi mundësinë e stacionit të realizojë funksionet kryesore. Mbi të gjitha, ndryshimet e shpeshta të strukturave udhëheqëse dhe redatoriale, kombinuar me tentimet e pasuksesshme për përmirësimin e skemës programore, kishin një ndikim negativë mbi transformimin e stacionit.

Sfida kryesore e sektorit komercial është në të ardhmen do të jetë ridefinimi kuantitativë dhe kualitativë ofertës programore dhe digjitalizimi.

## **ANEKS 1. LEGJISLACIONI I CITUAR NË KËTË RAPORT**

Ligji për zgjedhjet Gazeta zyrtare e RM-së nr 40/06.

Ligji për veprimtari radiodifuzive Gazeta zyrtare e RM-së nr. 100/05. (në vazhdim të tekstit Ligji për radiodifuzion)

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtari radiodifuzive Gazeta zyrtare e RM-së nr 10/07

Ligji për komunikime elektronike Gazeta zyrtare e RM-së nr13/05.

Ligji për themelimin e NP Radio televizioni I Maqedonisë Gazeta zyrtare e RM-së nr 6/98

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e NP Radio televizioni i Maqedonisë Gazeta zyrtare e RM-së nr78/04

## ANEKS 2. BIBLIOGRAFI

### Në anglisht

- Broadcasting Council. “Analysis of the programmes offered for the harmonisation of the concession titles with the broadcast licenses”, 2007.
- Broadcasting Council. “Handbook for the formats of the radio and television programme services”, 30 October 2006.
- Broadcasting Council. Monitoring report by the Broadcasting Council on coverage of the election campaign of the 2006 parliamentary elections.
- Broadcasting Council. Monitoring of the radio and televisions’ programme, Broadcasting Council, internal document, 2007.
- Broadcasting Council. Report of Broadcasting Council of the Republic of Macedonia from 1 January 2006 to 31 December 2006.
- Broadcasting Council. *The Bulletin of the Broadcasting Council of the Republic of Macedonia*, Vol. 1, 1998.
- Commission of the European Communities. The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2007, Progress Report accompanying the communication from the Commission to the European Parliament and the Council. Enlargement Strategy and Main Challenges 2007–2008, COM (2007) 663 Final, Brussels, 6 November 2007, SEC(2007) 1432.
- Government of the Republic of Macedonia. “Answers to the Additional Questions for the Economic Criteria and the Chapters of the *Acquis* for European membership”.
- IP International Marketing Committee. *Television 2007. International Key Facts*, October 2007.
- MRT. “Declaration on Professional and Ethical Principles for Programmes”, 2003, Skopje, internal MRT document, available in the MRT archives.
- SMMRI. Top 20 programmes in 2006, Skopje.
- Statute of the public enterprise Macedonian Radio Television.

### Në maqedonisht

- Radiodifuzion të RM “Raporti i Këshillit për Radiodifuzion të RM-së për periudhën nga 01.01.2007 deri më 31.12.2007”, Shkup mars 2008.
- MIM, Pronësia e mediave dhe ndikimi i saj mbi pavarësinë e mediave dhe pluralizmit, Shkup, 2004.
- Media & Advertising, “Analytica”, Skopje, 2007.
- Strategic Marketing and Media Research (SMMRI), “Nevojat programore të publikut televiziv në Republikën e Maqedonisë” qershor 2007.